



**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**

**RAPORT
I INSPEKTIMIT MBI MENAXHIMIN E RUAJTJES DHE
KONTROLLIT TË KUFIRIT DHE MIGRACIONIT**

Nr. 5/2019

Prishtinë, 16 dhjetor 2019

Informata të përgjithshme

Titulli	Raport i inspektimit mbi menaxhimin e ruajtjes dhe kontrollit të kufirit dhe migracionit
Data e përgatitjes	16 dhjetor 2019
Përgatitur nga	Linda Ahmeti, udhëheqëse e ekipit të inspektimit, Kadri Keçmezi, inspektor
Mbikëqyrur nga	Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	Miradije Kelmendi, Kryeshef Ekzekutiv, Inspektorati Policor i Kosovës
Data e miratimit	16 dhjetor 2019



1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-6)
- 1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....(6-6)

2. Hyrje

- 2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....(7-7)
- 2.2. Qëllimi.....(7-7)
- 2.3. Objekti.....(7-7)
- 2.4. Subjekti.....(7-7)
- 2.5. Objektivat e inspektimit.....(7-8)
- 2.6. Rëndësia e inspektimit.....(8-8)
- 2.7. Metodologjia e inspektimit.....(8-9)
- 2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit.....(9-9)
- 2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit.....(9-9)
- 2.10. Drejtimet e inspektimit.....(9-9)
- 2.11. Kriteret e vlerësimit.....(9-10)
- 2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektive.....(10-10)

3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1. Kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit.....(11-18)
- 3.2. Aktivitetet policore në parandalimin, hetimin dhe zbulimin e krimit(18-22)
- 3.3. Mbikëqyrja dhe kontrollimi i shtetasve të huaj në territorin e vendit(22-25)
- 3.4. Kapacitetet e burimeve njerëzore dhe teknike.....(25-32)

4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1. Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(33-35)

Shtojcat

1. Përmbledhja ekzekutive

1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit

1.1.1. Sipas legjislacionit në fuqi janë të ndara përgjegjësitë për ruajtjen dhe kontrollin kufitar. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka kompetencë mbi kontrollin kufitar kurse Departamenti për Kufi si pjesë strukturore e Policisë, është përgjegjës për Kontrollë dhe Mbikëqyrje në të gjitha Stacionet Policore Kufitare (SPK), si dhe Stacionet Policore të Mbikëqyrjes së Kufirit (SPMK). Departamenti për Kufi ka autorizime e përgjegjësi në kontrollin e mbikëqyrjen kufitare, kontrollin e hyrjes, qëndrimit dhe lëvizjes së të huajve, parandalimin dhe luftimin e krimit ndërkufitar. Në kuadër të Departamentit për Kufi funksionojnë Drejtoritë Rajonale të Policisë Kufitare (DRPK), të cilat janë të ngarkuara të zhvillojnë aktivitetin operacional në terren në kontrollin kufitar dhe mbikëqyrjen e vijes kufitare. Këto drejtori kanë në kuadër të tyre SPK-të, të cilat janë të hapura varësisht nga kategorizimi i tyre. Derisa ato të kategorisë A dhe B janë të hapura 24 orë në ditë, ato të kategorisë C janë të përkohshme. Drejtoritë kanë në kuadër të tyre edhe SPMK-të, të cilat patrollojnë zonën kufitare përgjatë 24 orëve dhe mbulojnë tërë zonën kufitare që përshkon vijen e kaltërt dhe të gjelbërt.

1.1.2. Patrullat kufitare të SPMK-ve janë gjetur në përbërje të plotë, me ndarje të duhur të roleve të pjesëtarëve të tyre dhe në respektim të orarit ditor patrullues. IPK-ja është ndarë e kënaqur me transmetimin (bartjen) e informacionit nga ndërrimi në ndërrim dhe raportimin nga udhëheqësit e ndërrimeve. Komunikimi nga terreni nga patrullat kufitare në disa raste konsiderohet i vështirësuar dhe larg pritjeve, për arsye objektive dhe subjektive. Procedura e pranim-dorëzimit të armëve të gjata aplikohet në të gjitha SPK-të dhe SPMK-të, por ka nevojë që në disa prej tyre, informatat mbi procedurën të jenë më të plota. Është evidentuar se përgjithësisht në nivel vendi ka shtim të disa nga masat e kontrollit kufitar përgjatë vijes kufitare, përfshirë patrullimet me automjete, patrullimet në këmbë dhe pikave të kontrollit. Gjatë vitit në disa periudha kohore, SPK-të kanë aplikuar masat e lehtësimit kufitar përshkak të fluksit të qytetarëve dhe automjeteve. IPK-ja është ndarë e kënaqur me organizimin, si dhe funksionimin e kontrollit të vijes së parë dhe të dytë të realizuar nga SPK-të. Numri i kontrolleve të personave dhe automjeteve në Pikat e Kalimit Kufitar (PKK) përgjithësisht në nivel vendi ka shënuar ngritje krahasuar me vitet e fundit. Vërmica dhe Hani i Elezit vazhdojnë të mbesin pika më të frekuentuara dhe mbajnë primatin për numrin më të madh të kontrolleve në raport me numrin e policëve. Numri i kontrolleve të personave në vijen e dytë në nivel vendi ka shënuar ngritje, kurse Merdare dallohet me përqindjen më të lartë të kontrolleve të realizuara në raport me numrin e personave të kontrolluar në vijën e parë. Ngritje ka shënuar edhe numri i kontrolleve të automjeteve në vijen e dytë, kurse Kulla dhe Jarinje kanë realizuar përqindjen më të lartë të këtyre kontrolleve në raport me numrin e automjeteve të kontrolluar në vijen e parë.

1.1.3. Në drejtim të zhvillimit të konceptit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK) në arritjen e objektivit për kufi të sigurt dhe të kontrolluar, Departamenti për Kufi ka shtrirë bashkëpunimin në tre nivelet e bashkëpunimit: në nivel të autoritetit, me autoritetet vendore në kuadër të MIK-ut dhe në rrafshin ndërkombëtar. Statistikat nuk pasqyrojnë trende të kënaqshme dhe shtrohet nevoja që të analizohen indikatorët që pasqyrojnë angazhimet policore në tre rrafshet e bashkëpunimit dhe më pas të identifikohen shkaqet që kanë për rrjedhojë rezultatet jo të kënaqshme në frymën e

këtyre bashkëpunimeve. Bashkëpunimi me FRONTEX-in¹ po konsiderohet i frytshëm në nivel të përfshirjes në takimet e organizuara dhe në misionet për kontrollë të kufijve të jashtëm të Shengenit dhe në aeroporte të vendeve të Shengenit. Analiza, si dhe vlerësimi i riskut realizohet në nivelin strategjik, operacional dhe atë taktik, kurse përshkak të ndryshimit të Procedurës Standarde të Operimit, kanë ndryshuar edhe afatet kohore të raportimit. Në drejtim të parandalimit dhe luftimit të krimit ndërkufitar, njësitë hetimore kanë trajtuar rastet e iniciuara, numri i të cilave në nivel departamenti në dy vitet e fundit është afërsisht i baraspeshuar dhe afërsisht gjysma e tyre janë kategorizuar vepra penale dhe gjysma si kundërvajtje. DRPK-Lindja dhe Perëndimi kanë shënuar numrin më të madh të veprave penale dhe kundërvajtjeve në dy vitet e fundit. Kontrolli i dosjeve hetimore të mostruara vë në pah një praktikë të papranueshme të mirëmbajtjes së tyre, meqë nuk përmbajnë tërë dokumentacionin e përcaktuar me procedurat në fuqi dhe kjo shtron nevojën për ushtrimin e një kontrolli më rigoroz ndaj njësitëve hetimore.

1.1.4. Në fushën e kontrollit të migracionit, në vitin e fundit janë evidentuar më pak raste të refuzimit të hyrjes së shtetasve të huaj në territorin e vendit tonë. Nuk është hasur të ketë lëvizur brenda territorit tonë përmes PKK-ve ndonjë shtetas i huaj që nuk përmbushë kriteret për hyrje. Gjatë kontrollit të dosjeve të largimeve të shtetasve të huaj nga territori i vendit tonë janë vërejtur mungesa të theksuara të dokumenteve, andaj kjo praktikë është e papranueshme dhe nevojitet një kontroll i shtuar në eliminimin e dobësive. Numri i vizave të lëshuara në PKK është simbolik, lidhur me to mbahen evidencat përkatëse dhe se janë lëshuar në përputhje me kriteret e përcaktuara. Me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), Departamenti për Kufi përmes Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj (DMH) ka kryer verifikimin e gjendjes faktike të aplikuesve të vizave në misionet diplomatike dhe konsullore të vendit tonë dhe brenda afateve kohore ka kthyer raportet e verifikimit (inspektimit) me rekomandimet e nevojshme. Raportet me rekomandime negative kanë shënuar rënie në vitin 2018 krahasuar me një vit më parë. Dosjet e verifikimit janë të kompletuara dhe përmbajnë kërkesat dhe raportet e verifikimit. Trajtimi fillestar i azilkërkuessve vlerësohet të jetë i realizuar konform standardeve të përcaktuara. Dosjet e rasteve janë të kompletuara dhe i janë dorëzuar Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM) brenda afateve të parapara.

1.1.5. IPK-ja gjatë këtij inspektimi ka gjetur një gjendje më të kënaqshme sa i përket kapaciteteve të angazhuara të burimeve njerëzore, me gjithë tejkalimet dhe mungesat në disa pjesë strukturore. Vazhdon të ketë shpërputhje sa i përket personelit të graduar në një numër pozitash, meqë ka ende raste kur pozitat ushtrohen nga punonjës me grada joadekuate. Në drejtim të avancimit të njhurive dhe shkathtësive të personelit, vërehet një ecje pozitive në përmbushjen e agjendës në trajnimet e brendshme, ngase ka një përfshirje më të gjërë të personelit. Ka hapa inkurajues në implementimin e Strategjisë Anti-Korrupsion dhe kjo është pozitive në ngritjen e integritetit policor, ngase lëvizja e personelit minimizon mundësitë për abuzim. Kontrollat e kualitetit paraqesin aktivitet me rëndësi në ngritjen e cilësisë së punës, kanë identifikuar vështirësitë dhe sfidat, por në të ardhmen duhet të prekin edhe fushat e ndjeshme, përfshirë edhe hetimet. Përgjatë vijes kufitare janë vendosë sisteme monitorimi dhe ato paraqesin mundësi për një kontroll të avancuar. Sistemet e tilla funksionojnë

¹ The European Border and Coast Guard Agency (FRONTEX) është një nga agjencitë e sigurisë së Bashkimit Europian, me detyrë ruajtjen e kufijve të jashtëm të vendeve të hapësirës Shengen, si dhe menaxhimin e flukseve migratore jo të rregullta që synojnë vendet e hapësirës. Agjencia është e specializuar në analizën e informacionit dhe të risqeve migratore të parregullta në mbështetje të rojave kufitare të vendeve, ku shtrihen kufijtë e jashtëm evropian si dhe koordinimin e tyre në mënyrë të përqendruar në menaxhim krizash migratore në tokë dhe në det.

bazuar në kriteret e përcaktuara dhe u shërbejnë patrullave të SPMK-ve që të kenë nën vëzhgim pika të nxehta të vijes kufitare për ndonjë aktivitet të mundshëm kriminal. Gjendja me automjete patrulluese është e rënduar dhe paraqitet e papërmirësuar nga inspektimi i kaluar. Është evidentuar mungesë dhe jofunksionalitet i një numër pajisjesh policore në SPK dhe SPMK, me çka mund të vështirësohet puna efektive e njësive policore. Sistemi i Menaxhimit Kufitar (SMK) vlerësohet të jetë funksional në të gjitha PKK-të. Stop Lista është funksionale në kuadër të SMK-së, por ende janë evidente problemet me freskimin e të dhënave si pasojë e komunikimit jo azhur dhe vonesave në pranimin e vendimeve gjyqësore. Në disa SPK duhet shtuar masat e sigurisë për ruajtjen e serverëve, duke u përkujdesur që të jenë të mbrojtur. Kushte më të mira të ruajtjes nevojitet edhe për vulat në disa nga SPK-të.

1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

1.2.1. Nga inspektimi i kryer ka rezultuar se nga tetë (8) rekomandime të lëna në inspektimin e kaluar (inspektimi nr. 06/2017), një (1) prej tyre është përmbushur plotësisht, pesë (5) janë përmbushur përgjithësisht (në masë të madhe), një (1) është përmbushur pjesërisht dhe një (1) nuk është përmbushur fare (*për më tepër referoju tabelës në shtojcën 1*).

2. Hyrje

2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK-ja ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Policinë për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar një shërbim profesional, demokratik e të përgjegjshëm. Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit të IPK-së (2019) ka përfshirë kryerjen e inspektimeve në disa fusha të menaxhimit, përfshirë edhe atë të ruajtjes dhe kontrollit të kufirit, si dhe migracionit. Inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit paraqet fushë me interes për IPK-në me qëllim të vlerësimit nëse Policia ka kapacitete të mjaftueshme teknike e njerëzore për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit, për të lehtësuar qarkullimin e lirë të njerëzve dhe mallrave, për të siguruar kufij të hapur dhe të sigurt, për të luftuar krimin ndërkuftar, për të përmbushur objektivat strategjike në menaxhimin e integruar të kufirit dhe për të kontrolluar migracionin. Nevojitet që profesionalizmi, përkushtimi, transparencja dhe llogaridhënia të jenë evidente në menaxhimin efektiv të ruajtjes dhe kontrollit të kufirit e migracionit. Po ashtu, IPK-ja është e interesuar të rishikojë edhe nivelin e përmbushjes së rekomandimeve të dhëna në inspektimin e kaluar të realizuar në këtë fushë, të cilat janë pasqyruar në Raportin e inspektimit nr. 06/20017. Duke kuptuar rëndësinë e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 6 qershor 2019, mbi bazën e Programit të miratuar të punës inspektuese të po të njëjtës datë, ka inicuar një inspektim për të vlerësuar performancën policore në këtë fushë të menaxhimit.

2.2. Qëllimi i inspektimit

2.2.1. Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret dhe parimet e procedurat policore përkatëse zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet;
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e saja;
- Që të jepet opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me fushën e menaxhimit të kufirit;
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë punës në fushën përkatëse;
- Që të identifikojë mangësitë - dobësitë dhe të rekomandojë masa ligjore e organizative për funksionimin më të mirë të policor.

2.3. Objekti i inspektimit

2.3.1. Në këtë inspektim të rregullt është vlerësuar kryerja e detyrave në fushën e menaxhimit të ruajtjes dhe kontrollit të kufirit e migracionit.

2.4. Subjekti i inspektimit

2.4.1. Inspektimi është përqendruar në Departamentin për Kufi, divizionet, drejtoritë rajonale policore kufitare, stacionet policore kufitare dhe stacionet policore të mbikëqyrjes kufitare.

2.5. Objektivat e inspektimit

2.5.1. Objektivat që synon t'i arrijë ky inspektim janë:

- Vlerësimi i kapaciteteve operacionale për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit;
- Vlerësimi i realizimit të Planit Strategjik për Menaxhimin e Integruar të Kufirit;
- Vlerësimi i respektimit të rregullave - procedurave në hetimin e krimit ndërkufitar;
- Analizimi dhe vlerësimi i indikatorëve të nivelit të krimit dhe performancës policore;
- Vlerësimi i kryerjes së detyrave gjatë kontrollit dhe patrullimit kufitar;
- Vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave të kontrollit të migracionit dhe qëndrimit të të huajve në vendin tonë;
- Vlerësimi i kushteve të punës dhe funksionimit të Sistemit të Menaxhimit Kufitar;
- Vlerësimi i përmbushjes së rekomandimeve të inspektimeve të kaluara.

2.6. Rëndësia e inspektimit

2.6.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ushtrimin e kontrollit adekuat për të siguruar shkallë më të lartë të punës profesionale, llogaridhënies, transparencës, besueshmërisë në menaxhimin e kufirit;
- Ngritjen e përgjegjësisë në respektimin me përpikëri të procedurave për patrullimet dhe kontrollet kufitare, drejt sigurimit të lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave;
- Ngritjen e vetëdijes policore për të kontribuar më me përkushtim në parandalimin dhe zvogëlimin e akteve të paligjshme në zonat kufitare;
- Ngritjen e besimit të qytetarëve mbi përkushtimin policor në menaxhimin e kufirit dhe lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave.

2.7. Metodologjia e inspektimit

2.7.1. Gjatë inspektimit:

- a) Janë zhvilluar intervista dhe takime me punonjës dhe bartës të funksioneve, si: Drejtorin e Departamentit për Kufi, Drejtorët e DRPK-ve, Komandantët e SPK-ve (kategoria A), Komandantët e SPMK-ve dhe Udhëheqësit e patrullave kufitare në kuadër të SPMK-ve.
- b) Janë kryer inspektime (verifikime) fizike të: përbërjes së patrullave kufitare dhe ndarjes së roleve brenda tyre, prezencës dhe angazhimit të ekipeve të profilimit në kontrollin e vijes së parë dhe të dytë, informatave në SMK mbi qarkullimin e personave, mbulimit të vendeve të punës dhe sistemimit të burimeve njerëzore dhe gradave, aplikimit të masave anti-korrupsion, vendosjes së kamerave përgjatë vijes kufitare dhe mbulimit të terrenit, pajisjes së patrullave me pajisje, të pajisjes së stacioneve kufitare me pajisje për kontrollin e vijes së parë dhe të dytë, funksionimit të SMK-së dhe aplikimit të masave të sigurisë në dhomat e serverëve, aplikimit të masave të sigurisë për ruajtjen e vulave.
- c) Janë plotësuar formularët e inspektimit për verifikim të: pajimit të patrullave kufitare me pajisje apo mjete pune, pajimit të SPK-ve me pajisje për kontrollin e vijes së parë dhe të dytë, si dhe masave të sigurisë për ruajtjen e vulave zyrtare.
- d) Janë siguruar: oraret e patrullimit, radiologjet për tre ditët e fundit, formularët e pranimit-dorëzimit të armëve të gjata në tre ndërrimet e fundit, raportet vjetore të punës, Evidenca e masave të lehtësimit kufitar, oraret e ekipeve të profilimit në kontrollin e vijes së parë

dhe të dytë, mostrat e evidencave të kontrollit të vijes së dytë të tre ndërrimeve të fundit, planet e përbashkëta me autoritetet e MIK-ut dhe raportet mbi rezultatet e operacioneve, marrëveshjet dhe protokollet e bashkëpunimit me shtetet fqinje, të dhëna përmbledhëse mbi numrin e raporteve sipas nivelit taktik, operativ e strategjik në funksion të analizës së përbashkët të rrezikut për PKK-të, dosjet hetimore (5 për vitin 2017 dhe 5 për vitin 2018), Evidenca për refuzimin e hyrje-daljes në kufi, dosjet e refuzimit të hyrje-daljeve (10 për vitin 2017 dhe 10 për vitin 2018), Evidenca e personave të deportuar me urdhër Gjykate dhe urdhërlargim me forcë, dosje të rasteve të deportimit të të huajve me urdhërlargim me forcë (8 për vitin 2017 dhe 8 për vitin 2018, përfshirë rastet me nr: 08/17, 779/17, 841/17, 236/2017, 210/2017, 234/2017, 008/2017, 68/2017, 19/2018, 55/2018, 3386/18, 87/2018, 148/2018, 157/2018, 27/2018, 31/2018), Evidenca mbi vizat e lëshuara në PKK, dosjet e vizave të lëshuara në PKK (5 për vitin 2017 dhe 5 për vitin 2018), Lista e kërkesave për verifikim të aplikantëve për viza, raportet e verifikimit-inspektimit mbi aplikimet për viza (3 për vitin 2017 dhe 3 për vitin 2018, përfshirë dosjet e verifikimit me nr.: 237/2017, 236/2017, 234/2017, 217/2018, 7/2018, 6/2018), Evidenca mbi azilkërkuesit, dosje të rasteve të azilkërkuesve (3 për vitin 2017 dhe 3 për vitin 2018, përfshirë dosjet me datë: 31.12.2017, 15.11.2017, 04.11.2017, 13.09.2018, 12.09.2018 dhe 10.10.2018), të dhëna mbi burimet njerëzore të Departamentit, të dhëna mbi trajnimet, raportet e kontrollit të kualitetit (3 raporte të fundit).

2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit

2.8.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar me datën 17.06.2019 dhe ka përfunduar me datën 16.07.2019.

2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit

2.9.1. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave nga drejtoritë përkatëse gjatë periudhës dy vjeçare (2017-2018) dhe gjendjen aktuale të menaxhimit.

2.10. Drejtimit e inspektimit

2.10.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit;
- Aktivitetet policore në parandalimin, hetimin dhe zbulimin e krimit;
- Mbikëqyrja dhe kontrollimi i shtetasve të huaj në territorin e vendit;
- Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe teknike.

2.11. Kriteret (standardet) e vlerësimit

2.11.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave:

- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës;
- Ligji i Policisë,

- Ligji për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror;
- Ligji për të Huajt;
- Rregullorja për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës;
- Rregullorja për Operativë;
- Udhëzimet Administrative që rregullojnë fushat me interes për inspektimin;
- Procedurat Standarde të Operimit që rregullojnë veprimet në fushat e inspektimit;
- Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (2013-2018);
- Plani Zhvillimor Strategjik i Policisë së Kosovës (2016-2019).

2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave

2.12.1. IPK-ja vlerëson se gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk ka hasur në ndonjë vështirësi që do të ndikonte në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna me Programin e punës inspektuese.

3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

3.1. Kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit

3.1.1. Sipas Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, kontrolli kufitar përkufizohet si kontroll i kryer në pikat e kalimit kufitar për të siguruar që personat, mallrat dhe mjetet e tyre të transportit janë të autorizuar të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës apo të lëshojnë Republikën e Kosovës. Në kuadër të tre (3) DRPK-ve dhe Stacionit Policor-Aeroporti janë 16 Stacione Policore Kufitare në Pikat e Kalimit Kufitar, të kategorizuara në A, B dhe C, kurse edhe tre (3) të tjera janë në proces për t'u funksionalizuar². SPK-të e kategorisë A janë të hapura 24 orë në ditë dhe shërbejnë për qarkullim të njerëzve, mjeteve dhe mallrave dhe në to vazhdimisht janë prezent Policia Kufitare, Dogana e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës. SPK-të e kategorisë B janë të hapura 24 orë në ditë dhe shërbejnë për qarkullim të personave, mjeteve dhe mallrave me sasi të kufizuar. SPK-të e kategorisë C janë të përkohshme dhe hapen në intervale të caktuara kohore me marrëveshje bilaterale me shtetet fqinje, si dhe shërbejnë vetëm për qarkullim të personave. Në kuadër të DRPK-ve funksionojnë po ashtu dhe 12 Stacione Policore të Mbikëqyrjes Kufitare që kanë për detyrë ruajtjen e kufirit shtetëror. Patrullimi i zonës kufitare ushtrohet nga patrullat kufitare të këtyre stacioneve përgjatë 24 orëve. Aktivitetet e patrulluese përgjatë vijes së gjelbërt dhe të kaltërt përfshijnë patrullimet e pavarura, patrullimet me autoritetet e përfshira në MIK dhe patrullimet e përbashkëta me shtetet fqinje dhe KFOR-in. Brenda këtyre aktivitetëve, varësisht prej territorit gjeografik të vijes kufitare, ekipet patrulluese praktikojnë patrullime në këmbë, patrullime me mjete (automjete, barka, saja motorik, motoçikleta), patrullime të kombinuara, vëzhgime të fshehta, prita policore dhe pika kontrolli.

3.1.2. Fokus i inspektimit ka qenë përbërja e patrullave policore në mbikëqyrjen e vijes kufitare, nëse aktivitetet e tyre kanë qenë në harmoni me oraret ditore të angazhimit, si dhe ndarja e roleve të policëve përbrenda përbërjes së patrullave kufitare³. IPK-ja ka hasur në gjashtë patrulla kufitare në terren gjatë inspektimit të realizuar në SPMK-të në kuadër të DRPK-Lindja (Gjilan dhe Zhegër), DRPK-Perëndimi (Gjakovë dhe Vitomiricë) dhe DRPK-Veriu (Kërpimëh dhe Keqekollë). IPK ka gjetur që përbërjet e patrullave policore në mbikëqyrjen e vijes kufitare kanë qenë sipas orarit ditor në kuadër të ndërrimeve dhe se funksionimi dhe ndarja e roleve dhe detyrave të policëve patrullues në kuadër të patrullave kufitare ka qenë konform Procedurës Standarde të Operimit, kapitulli IV, pika 5). Patrullat kufitare kanë patur në përbërjen e tyre nga tre (3) deri në pesë (5) polic patrullues siç parashihet me PSO. Ky dokument përcakton që çdo ekip patrullues duhet të përbëhet nga së paku tre zyrtarë policor, ku njëri prej tyre duhet të caktohet si udhëheqës i ekipit patrullues, që duhet të ketë përvojë në mbikëqyrjen e kufirit dhe njohuri për karakteristikat e rajonit patrullues. IPK çmon angazhimin dhe përkushtimin e drejtuesve dhe policëve patrullues për përmbushjen e detyrave konform rregullave dhe procedurave, njëherit i inkurajon ato të vazhdojnë me të njëjtin përkushtim, duke i kontribuar ngritjes së performances dhe efektivitetit të kryerjes së detyrave.

3.1.3. IPK është fokusuar në vlerësimin e mënyrës së komunikimit (transmetimit) të informatave nga udhëheqësit e ndërrimeve paraprake tek patrullat kufitare që pranojnë detyrat siç parashihet

² Kapi, Izvor dhe Stançiq.

³ Departamenti për Kufi, *PSO - Standardet e Mbikëqyrjes së Kufirit*, DDK-05/308/15, datë 04.05.2015.

në kapitullin IV, pika 5 të PSO-së. Kjo lidhet me mënyrën e njoftimit të zyrtarëve patrullues para çdo patrullimi me informata të nevojshme dhe raportimin mbi angazhimet e ndërrimeve paraprake. Proceduralisht parashihet që para fillimit të patrullimit, patrullat duhet të njoftohen mbi vlerësimin e rrezikut, situatën në zonë, lokacionin e patrullave tjera, zonën patrulluese, fjalëkalimet në rast komunikimi me patrullat tjera, pajisjet e nevojshme, afatet dhe lokacionet për stacionim. Nga intervistat e realizuara me udhëheqës ndërrimesh dhe udhëheqës patrullash kuptohet se pranim-dorëzimi i detyrës në kuadër të ndërrimeve dhe patrullave kufitare përcillet me një komunikim të ndërsjellë. Procedura Standarde e Operimit parasheh që pas përfundimit të aktivitetit patrullues, udhëheqësi i patrullës është i obliguar të përpilojë raport lidhur me ngjarjet që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e kufirit, masat dhe aktivitetet e ndërmarra. Nga raportet e siguruar mbi pranim-dorëzimin e detyrës nga udhëheqësit e ndërrimeve dhe udhëheqësit e patrullave kufitare, vërtetohet transmetimi i informatave nga ndërrimi paraprak. Kjo paraqet seriozitet në ofrimin e informacionit të nevojshëm, duke i bërë patrullat kufitare më mirë të informuara dhe të mobilizuara me gjendjen në zonën patrulluese.

3.1.4. Një nga faktorët e rëndësishëm që ndihmon në organizimin, si dhe funksionimin e duhur patrullues padyshim se është komunikimi i patrullave kufitare në terren me autoritetin mbikëqyrës siç parashihet në kapitullin IV, pika 5 të Procedurës Standarde të Operimit⁴. Parashihet që së paku në çdo 30 minuta, zyrtarët udhëheqës duhet të informojnë udhëheqësit e ndërrimeve ose zyrtarët kujdestar për lokacionin e patrullave kufitare. Inspektimi vë në pah se ky standard është vështirë i arritshëm përshkak të disa vështirësive evidente. Vlerësohet se patrullat kufitare hasin në vështirësi për të komunikuar me autoritetin mbikëqyrës. Shumica e policëve kanë mungesë të radiolidhjeve, por edhe një numër i tyre që janë në dispozicion, janë në gjendje jo të mirë teknike. Vështirësi evidente në komunikim gjatë patrullimit në terren sjellin edhe zonat gjeografike të konsideruara të vdekuara dhe që nuk mbulohen me rrjet komunikimi, duke bërë që mungesa e valëve mos të ofrojë qasje. Komunikimi i patrullave në shumicën e rasteve sidomos në këto zona bëhet me telefona celularë duke shfrytëzuar edhe aplikacionet elektronike. Mungesa e pajisjeve dhe vështirësitë në komunikim konsiderohen një nga arsyet që nuk mund të arrihet standardi i kërkuar për komunikim efikas dhe të shpeshtë. IPK-ja nxitë patrullat kufitare që në përjashtim të rasteve kur ato ndodhen në zona të pambuluara me rrjet, të respektojnë procedurën dhe rregullat për të raportuar në intervale kohore siç parashihet me PSO.

Rekomandimi nr. 1

IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi dhe Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbeshtetëse që të angazhohen në ndërmarrjen e veprimeve për përmirësimin e infrastrukturës së komunikimit në drejtim të mbulimit të zonave të vdekura me rrjet komunikimi, si dhe në furnizimin e patrullave kufitare me pajisje të radio-komunikimit (radiolidhje).

3.1.5. Gjatë aktiviteteve rutinore të ndërrimeve, ekipet patrulluese duhet të ngarkohen edhe me pajisje, si armë dhe pajisje të nevojshme për kryerjen e detyrave policore. Prandaj, gjatë pajisjes së ekipeve patrulluese është rregullë aplikimi formal i procedurës së pranim - dorëzimit të armëve ndërmjet personelit policor, duke aplikuar formularë të posaçëm të evidencës. Procedura Standarde e Operimit - Mënyra e përdorimit të armëve të gjata, në kapitullin III, pika 3, veç tjerash përcakton

⁴ Departamenti për Kufi, PSO - Standardet e Mbikëqyrjes së Kufirit, DDK-05/308/15, datë 04.05.2015.

se pranim-dorëzimi i armëve të gjata dhe municionit bëhet përmes regjistrimit të pranim-dorëzimit sipas formës së paraqitur në Aneks A. Lidhur me këtë janë inspektuar mostra të formularëve mbi evidencën e pranimit-dorëzimit të armëve në ndërrimet e ditëve të fundit. Vlerësohet se në kuadër të SPK-ve dhe SPMK-ve, procedura e pranim-dorëzimit të armëve respektohet në përgjithësi. Nga mostrat e formularëve të ditëve të fundit janë vërejtur disa mangësi në mbajtjen e evidencave që lidhen me plotësimin e tyre. Në SPK-Merdare, SPMK-Kërpimëh dhe SPMK-Vitorimicë janë evidentuar formularë të pranim-dorëzimit të armëve të gjata që u mungojnë disa informata, si: nënshkrimi i dorëzuesit, nënshkrimi i pranuesit dhe data-koha e kthimit të armës⁵. IPK vlerëson se mungesa e informacionit të tillë paraqet fushë të ndjeshme mbi kontrollin e armëve.

Rekomandimi nr. 2


IPK-ja u rekomandon drejtuesve të stacioneve dhe udhëheqësve të ndërrimeve që të ushtrojnë kontroll të shtuar në respektimin e procedurës dhe rregullave për pranim-dorëzimin e armëve të gjata, si dhe për mbajtjen e evidencave lidhur me procedurat e tilla, në drejtim të shtimit të masave të sigurisë për kontrollin e tyre.

3.1.6. Plani Zhvillimor Strategjik i Policisë së Kosovës (2016-2020) ka përcaktuar si objektiv strategjik: Zbatimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit në përputhje me standardet e Shengenit. Ky aktivitet realizohet nga SPK-të në PKK dhe SPMK-të përgjatë vijes kufitare. Patrullat kufitare veprojnë si ekipe statike dhe mobile përmes patrullimeve ose vendosjes në vendet që konsiderohen pika të nxehta. Patrullat praktikojnë patrullime në këmbë, patrullime me automjete, patrullime të kombinuara, vëzhgime të fshehta, prita policore dhe pika kontrolli. Mbikëqyrja e kufirit nga SPMK kryhet me qëllim të parandalimit të kalimit të paautorizuar të kufirit, luftimit të krimit ndërkufitar dhe aplikimit të masave ligjore ndaj personave që tentojnë të kalojnë kufirin në mënyrë ilegale. Janë analizuar dhe krahasuar disa nga aktivitetet patrulluese të stacioneve në kuadër të tre DRPK-ve. Përgjithësisht në nivel të tre drejtorive, në vitin 2018 ka shënuar ngritje numri i patrullimeve me automjete krahasuar me dy vitet e mëparshme, kurse Veriu gjatë vitit 2018 ka shënuar numrin më të madh të këtyre patrullimeve në tre vitet e fundit. Përgjithësisht në nivel të tre drejtorive, në vitin 2018 ka shënuar ngritje edhe numri i patrullimeve në këmbë, ku Perëndimi ka shënuar numrin më të madh të tyre. Përgjithësisht në nivel të tre drejtorive, në vitin 2018 ka shënuar ngritje numri i pikave të kontrollit krahasuar me një vit më parë, kurse Perëndimi po ashtu dallohet me numrin më të madh të tyre. Sa i përket këtij aktiviteti patrullues, shihet rënie drastike në vitin e fundit e pikave të kontrollit në kuadër të Veriut dhe Lindjes.

DRPK	Patrullime me automjete			Patrullime në këmbë			Pika të kontrollit		
	2016	2017	2018	2016	2017	2018	2016	2017	2018
Veriu	5.141	5.027	5.779	2.126	2.009	2.319	1.979	2.219	1.224
Lindja	4.171	4.372	4.121	3.923	3.553	4.262	7.682	3.597	3.004
Perëndimi	4.656	4.605	4.840	7.983	8.361	7.946	2.168	1.452	4.240
Gjithsej	13.968	14.004	14.740	14.032	13.923	14527	11.829	7.268	8.460

⁵ Më Merdare, në Regjistrin e pranim-dorëzimit të armëve të gjata mungon nënshkrimi i dorëzuesit të armës, në Kërpimëh, në Regjistër mungon nënshkrimi i pranimit të armës dhe në Vitorimicë, në Regjistër mungon data dhe koha e kthimit të armës.


3.1.7. IPK-ja ka nxjerrë disa indikatorë të vitit 2018 për të pasqyruar performancën e SPMK-ve në kontrollin dhe mbikëqyrjen e vijes kufitare. Patrullat kufitare të SPMK-ve në kuadër të Veriut kanë realizuar më së shumti patrullime me automjete brenda një ndërrimi 12 orësh (mesatarisht 8 patrullime). Patrullat kufitare të SPMK-ve në kuadër të Perëndimit kanë realizuar më shumti patrullime në këmbë brenda një ndërrimi 12 orësh (mesatarisht 11 patrullime). Patrullat kufitare të SPMK-ve në kuadër të Perëndimit kanë realizuar më së shumti pika kontrolli brenda një ndërrimi 12 orësh (mesatarisht 6 pika kontrolli). Nga diagrami vërehet se numri i patrullimeve me automjet afërsisht është i balancuar në tre drejtoritë, derisa numri i patrullimeve në këmbë dhe i pikave të kontrollit është i ndryshëm varësisht nga drejtoria. Siç u potencua edhe më lartë, gjatë vitit 2018 Veriu ka shënuar numër më të ulët të patrullimeve në këmbë dhe pikave të kontrollit krahasuar me dy drejtoritë tjera. Nga indikatorët e performancës shihet se nevojitet analizë menaxheriale mbi shkaqet që kanë shtyrë në rënien e numrit të pikave të kontrollit në kuadër të Veriut. IPK vlerëson se duhet t'i kushtohet kujdes i duhur metodave të përdorura të patrullimit në mënyrë që vija kufitare të jetë e mbikëqyruar dhe e mbuluar me aktivitet patrullues nga patrullat kufitare, sidomos kur kemi parasysh vijen e ndjeshme kufitare që ndanë kufirin me Republikën e Serbisë.



3.1.8. Kontrolli kufitar kryhet në PKK-të për të siguruar që personat, mallrat dhe mjetet e tyre të transportit janë të lejuara të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës apo të lëshojnë Republikën e Kosovës. Me qëllim të shmangies së pritjeve të gjata si rezultat i fluksit të madh të qytetarëve dhe mjeteve motorike në PKK, varësisht nga niveli i bashkëpunimit me shtetet fqinjë në fushat e policimit kufitar është paraparë edhe aplikimi i masave lehtësuese të kontrollit kufitar. Intervistat me drejtues të SPK-ve tregojnë se në përgjithësi Policia Kufitare gjithnjë është vigjilente krahas pritjeve të gjata dhe angazhimi i tyre është maksimal gjatë sezonave verore apo periudhave tjera të vitit për menaxhimin e fluksit të madh të automjeteve dhe udhëtarëve, siç e përcakton PSO-ja. Sipas të gjeturave nga terreni, në SPK-Merdare dhe SPK-Vërmicë janë aplikuar masat e lehtësimit të kontrollit kryesisht gjatë sezonës verore, ndërsa gjatë periudhave tjera këto procedura aplikohen në raste shumë specifike kur nuk mund të menaxhohet fluksi i madh i automjeteve dhe udhëtarëve. Tek SPK-Hani Elezit, SPK-Jarinje dhe SPK-Kullë nuk janë aplikuar masa të lehtësimit për kontroll kufitar, sepse nuk janë krijuar rrethanat që shtyejnë aplikimin e masave të tilla. Në SPK-Dheu i Bardhë, me gjithë faktin se në disa periudha ka nevojë për aplikimin e masave lehtësuese, këto masa nuk mund të aplikohen përshkak të mungesës së gatishmërisë nga pala tjetër përtej kufirit.

3.1.9. Policia Kufitare kryen kontrole në PKK mbi ligjshmërinë e hyrje-daljeve të personave, gjëseneve, automjeteve dhe bagazheve. Pjesa më e madhe e kontroleve kryhen në vijen e parë të kontrollit⁶ dhe në situata të dyshimta edhe në vijen e dytë⁷. Fokus i inspektimit ka qenë organizimi, funksionimi i ekipeve të profilimit në kontrollin kufitar të vijes së parë dhe ekipeve të inspektimit në kontrollin kufitar të vijes së dytë, si dhe kryerja e detyrave nga ekipet e tilla, siç përcaktohet në kapitullin IV, pika 4.3, 4.4 dhe 4.5 të Procedurës Standarde të Operimit- Profilimi në pikat e kalimit kufitar. Bazuar në oraret e ndërrimeve në SPK, inspektimin e realizuar mbi prezencën fizike të personelit të ekipeve të profilimit dhe inspektimit, si dhe mënyrën e kryerjes së këtyre kontroleve nga ekipet, është vlerësuar se organizimi, funksionimi dhe veprimet e Policisë janë ndërmarrë në harmoni me kapitullin IV, pika 4.3 dhe 4.4 të PSO-së.

3.1.10. Gjatë këtij inspektimi, fokus ka qenë krahasimi i indikatorëve të performances në fushën e kontrollit kufitar duke siguruar të dhënat nga raportet vjetore të katër viteve të fundit mbi aktivitetet e kontrollit kufitar. Kontrollat në hyrje-dalje në nivel vendi për persona dhe automjete në katër vitet e fundit kanë shënuar ngritje të vazhdueshme (kontrollat e personave kanë shënuar ngritje për 7.9%, 3.7% dhe 5.1% gjatë tre viteve të fundit, kurse kontrollat e automjeteve kanë shënuar ngritje për 8.7%, 12.5% dhe 3.6% në tre vitet e fundit krahasuar me periudhat paraprahe). Diagrami nr. 2 pasqyron trendet në ngritje të kontroleve të personave dhe automjeteve në hyrje dhe dalje të vendit tonë, të realizuara në të gjitha PKK-të.



⁶ Procedura Standarde e Operimit-Profilimi në pikat e kalimit kufitar, kontrollin e vijes së parë e përkufizon si kontrollë që kryhet si rregull mbi të gjithë udhëtarët për të verifikuar identitetin e tyre. Përbëhet nga verifikimi i shpejtë dhe i drejtëpërdrejtë i dokumenteve të udhëtimit me qëllim që të kontrollohet vlefshmëria e tyre dhe të zbulohet prania e shenjave të falsifikimit ose sajimit. Ky kontroll mund të përfshijë verifikimin në bazat e të dhënave, e informacioneve në lidhje me dokumentet e vjedhura, të falsifikuara, të shpërdorura, të humbura dhe të pavlefshme. Në bazë të këtij verifikimi autoritetet për sigurinë e kufirit marrin vendim që automjeti/personat/mallrat të futën për inspektim.

⁷ Kontrolli në vijën e dytë është kontrollim vazhdues mbi të gjithë udhëtarët, që sa herë që të jetë e mundur, duhet të kryhet në një vend të posaçëm i shmangur nga vendi ku të gjithë personat verifikohen (vija e parë). Inspektimi kryhet nga ekipi inspektues dhe përfshinë kontrollin e plotë të personave e dokumenteve e po ashtu edhe ekzaminimin e të gjitha kupeve dhe hapësirave në automjet që mund të përdorën për depozitimin e mallrave, personave e dokumenteve.

3.1.11. IPK-ja është fokusuar në performancën e SPK-ve të kategorisë A, të cilat viteve të fundit ballafaqohen me fluks më të madh të lëvizjes së personave e automjeteve. Vërmica mbetet stacioni më i frekuentuar që përfaqësohet me 34% apo afërsisht përfshinë 1/3 e të gjitha kontrolleve të personave në nivel vendi, pasuar nga Hani i Elezit me 16%. Të gjitha stacionet e kategorisë A, në përjashtim të Jarinjës dhe Merdarës, kanë shënuar ngritje të numrit të personave të kontrolluar. Brenda çdo minute në të gjitha PKK-të kontrollohen mesatarisht 34 persona. Vërmica frekuentohet mesatarisht nga 12 persona në minutë, pasuar nga Hani i Elezit me 5 persona. Sa i përket ngarkesës për polic, një polic i Vërmicës kontrollon mesatarisht 119.261 persona në vit, pasuar nga Hani i Elezit me 48.743. Kulla shënon numër më të ulët të personave të kontrolluar nga të gjitha stacionet e kategorisë A me çka dallon edhe ngarkesa e kontrolleve për polic. Polici i angazhuar në kontrollin kufitar të Vërmicës ka ngarkesë më të madhe të punës se cilido polic tjetër i angazhuar në cilindo stacion tjetër. Apo edhe e kundërta, polici i Kullës ka ngarkesë më të vogël të punës se cilido polic tjetër i angazhuar në cilindo stacion. Analizat mund t'i ndihmojnë menaxhmentit të lartë për të vlerësuar angazhimet dhe burimet e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve policore në kontrollet kufitare, ngase nëse vështrojmë vetëm numrin e kontrolleve në Vërmicë dhe Hani i Elezit, vërehet ngarkesë e shtuar nga viti në vit për policët që aplikojnë kontrollet.

Tabela nr. 2 - Indikatorët e performances lidhur me kontrollet në hyrje-dalje (2017/2018)						
SPK (A)	2017			2018		
	Numri i policëve	Persona të kontrolluar	Raporti polic/persona të kontrolluar	Numri i Policëve	Persona të kontrolluar	Raporti polic/persona të kontrolluar
Vërmicë	62	5.715.832	92.190	51	6.082.311	119.261
Kullë	30	429.787	14.326	29	450.145	15.522
Hani i Elezit	57	2.561.718	44.942	57	2.778.385	48.743
Dheu i Bardhë	45	1.490.717	33.127	44	1.542.820	35.064
Merdare	49	1.062.473	21.683	47	1.054.354	22.433
Jarinje	48	853.736	17.786	47	658.142	14.003
Aeroporti	85	1.882.034	22.141	83	2.114.839	25.479

3.1.12. Sipas të dhënave nga raportet vjetore kemi ngritje të numrit të kontrolleve të personave në vijën e dytë në nivel vendi. Në vitin 2017 janë regjistruar 57.169 kontrolle të personave, kurse në vitin 2018 kjo shifër arrinë në 78.199, apo 37% me shumë se një vit më parë në nivel vendi. IPK ka analizuar këto trende dhe pasqyron se gjatë vitit 2017 vetëm 0.33% e personave të kontrolluar në vijën e parë i janë nënshtruar kontrollit edhe në vijë të dytë. Gjatë vitit 2018 vetëm 0.44% e personave të kontrolluar në vijën e parë i janë nënshtruar kontrollit edhe të vijës së dytë. SPK-Merdare dallohet nga të gjitha stacionet e kategorisë A me përqindjen më të lartë të kontrolleve të realizuara të personave në vijën e dytë përgjatë dy viteve të fundit në raport me numrin e personave të kontrolluar në vijën e parë (1.59% për vitin 2017 dhe 3.13% për vitin 2018). Aeroporti mbetet stacioni me përqindjen më të ulët të kontrolleve të realizuara në vijën e dytë përgjatë dy viteve të fundit në raport me numrin e personave të kontrolluar në vijën e parë (0.04% për vitin 2017 dhe 0.02% për vitin 2018).

Tabela nr. 3 - Të dhëna përmbledhëse mbi indikatorët e performancës së SPK-ve në vijen e dytë të kontrollit të personave (2017/2018)						
SPK (A)	2017			2018		
	Persona të kontrolluar në vijen e parë	Persona të kontrolluar në vijën e dytë	%	Persona të kontrolluar në vijen e parë	Persona të kontrolluar në vijën e dytë	%
Vërmicë	5.715.832	9.794	0.17	6.082.311	12.789	0.21
Kullë	429.787	2.210	0.51	450.145	2.219	0.49
Hani i Elezit	2.561.718	7.331	0.28	2.778.385	7.024	0.25
Dheu i Bardhë	1.490.717	2.897	0.19	1.542.820	4.196	0.27
Merdare	1.062.473	16.996	1.59	1.054.354	33.039	3.13
Jarinje	853.736	3.759	0.44	658.142	5.845	0.88
Aeroporti	1.882.034	815	0.04	2.114.839	498	0.02

3.1.13. Në vitin 2018 pasqyrohet ngritje e numrit të kontrolleve në vijen e dytë edhe sa i përket numrit të automjeteve. Në vitin 2017 janë regjistruar 29.719 kontrolle të automjeteve, kurse në vitin 2018 kjo shifër arrinë në 31.167, apo 4.9 % më shumë se një vit më parë. Gjatë vitit 2017 vetëm 0.59% e automjeteve të kontrolluar në vijen e parë i janë nënshtruar kontrollit edhe të vijes së dytë. Kurse, gjatë vitit 2018 vetëm 0.60% e automjeteve të kontrolluar në vijen e parë i janë nënshtruar kontrollit edhe të vijes së dytë. SPK-Kullë dallohet nga të gjitha stacionet e kategorisë A me përqindjen më të lartë të kontrolleve të realizuara të automjeteve në vijen e dytë në vitin 2017 në raport me numrin e automjeteve të kontrolluar në vijen e parë (1.76%). Kurse në vitin 2018, SPK-Jarinje dallohet nga të gjitha stacionet e kategorisë A me përqindjen më të lartë të kontrolleve të realizuara të automjeteve në vijen e dytë në raport me numrin e automjeteve të kontrolluar në vijen e parë (1.25%). SPK-Dheu i Bardhë pasqyrohet si stacioni me përqindjen më të ulët të kontrolleve të realizuara në vijen e dytë në vitin 2017 në raport me numrin e automjeteve të kontrolluar në vijen e parë (0.26%). Kurse në vitin 2018, SPK-Hani i Elezit pasqyrohet si stacioni me përqindjen më të ulët të kontrolleve të realizuara në vijen e dytë në raport me numrin e automjeteve të kontrolluar në vijen e parë (0.24%). Vlerësohet se është e nevojshme të analizohen dhe rishikohen politikat e kontrollit kufitar lidhur me personat dhe automjetet, ngase në dukje pasqyrohet se trendi aktual i këtij lloji kontrolli mund të mos garantojë siguri në përmbushjen efektive të synimeve për ruajtje dhe mbikëqyrje cilësore të kufirit.

Tabela nr. 4 - Të dhëna përmbledhëse mbi indikatorët e performancës së SPK-ve në vijen e dytë të kontrollit të automjeteve (2017/2018)						
SPK	2017			2018		
	Automjete të kontrolluar në vijen e parë	Automjete të kontrolluar në vijën e dytë	%	Automjete të kontrolluar në vijen e parë	Automjete të kontrolluar në vijën e dytë	%
Vërmicë	1.854.462	7.059	0.38	1.875.899	8.165	0.43
Kullë	77.204	1.366	1.76	162.160	1.379	0.85
Hani i Elezit	1.056.175	2.884	0.27	1.129.486	2.798	0.24
Dheu i Bardhë	612.604	1.593	0.26	607.795	5.764	0.94
Merdare	381.190	3.421	0.89	375.813	2.816	0.74
Jarinje	363.455	3.722	1.02	362.370	4.554	1.25

Rekomandimi nr. 3

IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi që në bashkëpunim me Udhëheqësin Divizionit për Kontrollë dhe Mbikëqyrje të Kufirit, të analizojë trendet e kontrolleve të vijes së dytë për t'u siguruar se shkalla aktuale e kontrolleve të tilla është e mjaftueshme, në drejtim të përmbushjes së misionit për të garantuar siguri të shtuar kufitare dhe për të parandaluar dhe luftuar krimin ndërkufitar.

3.2. Aktivitetet policore në parandalimin, hetimin dhe zbulimin e krimit

3.2.1. Duke iu përmbajtur konceptit të MIK-ut në drejtim të arritjes së objektivit për kufi të hapur, të kontrolluar e të sigurt, Departamenti për Kufi ka bashkëpunim me shumë akterë në shkëmbimin e analizave të riskut, analizave vjetore dhe të raporteve të vlerësimit të kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda. Plani i Veprimit të Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit për tre nivelet e bashkëpunimit ka përcaktuar objektiva dhe veprime konkrete drej përmbushjes së këtij vizioni. Policia Kufitare është përfshirë në tre nivelet e bashkëpunimit në kuadër të MIK-ut. Në nivel brenda autoritetit, Policia Kufitare është përfshirë në shkëmbimin e analizave të riskut, vlerësimeve strategjike të Drejtorisë për Inteligjencë e Analiza (DIA) dhe raporteve mbi vlerësimet e kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda. Brenda Policisë janë organizuar takime në nivel operacional, por që duke krahasuar katër vitet e fundit, viti 2015 del të jetë viti me numrin më të madh të takimeve brenda Policisë (në vitin e fundit janë shtuar ndjeshëm takimet krahasuar me dy vitet e mëparshme). Menaxhimi i operacioneve në kufi kërkon vlerësime dhe analiza mbi situatën në kufi, informata mbi treguesit e rrezikut dhe kërcënimet e mundshme për sigurinë e kufirit dhe vendit. Në këtë drejtim, nga autoritetet e përfshira në MIK realizohen takime të rregullta periodike dhe nga Raporti Vjetor i Departamentit për Kufi, del se Policia ka marrë pjesë në takime të tilla, por që numri i tyre është në rënie nga viti në vit. Viti 2015 del të jetë viti me numrin më të madh të takimeve, në të cilat është përfaqësuar Policia (viti i fundit ka shënuar një ngritje krahasuar me një vit më parë). Në rrafshin ndërkombëtar janë realizuar takime me zyrtarë të shteteve fqinje me qëllim të ngritjes së efikasitetit në fushën e shkëmbimit të informacionit, kontrollit kufitar, hetimeve të përbashkëta, etj, por që numri i tyre gjithashtu është në rënie të vazhdueshme nga viti në vit. Edhe në këtë rrafsh, viti 2015 del të jetë viti me numrin më të madh të takimeve me shtetet fqinje, ku është përfaqësuar Policia (në vitin 2018 është shënuar rënia më e madhe e numrit të këtyre takimeve në tre vitet e fundit). IPK-ja vlerëson se duhet nxitur bashkëpunimi në rrafshin ndërkombëtar, meqë nga ai do të ketë efekte pozitive drejt luftimit të krimit ndërkufitar.

Tabela nr. 5 - Të dhëna mbi takimet e realizuara me autoritetet e MIK-ut dhe shtetet fqinje

Niveli i bashkëpunimit	2015	2016	2017	2018
Brenda Policisë	160	121	124	134
Autoritetet e MIK-ut	129	120	87	111
Bashkëpunimi ndërkombëtar	381	241	207	165

3.2.2. Meqenëse koncepti i MIK-ut nënkupton krijimin, zhvillimin dhe thellimin e bashkëpunimit me akterët e përfshirë në tre nivele, IPK-ja është interesuar të vlerësojë arritjet, duke krahasuar objektivat dhe veprimet e përcaktuara me Planin e Veprimit. Kur i referohemi bashkëpunimit brenda autoritetit, është vendosur objektiv për avancimin e bashkëpunimit në mes departamenteve policore. Në përmbushjen e objektivit të vënë, është ndarë detyrë që të organizohen operacione të

përbashkëta në ngritjen e efikasitetit në ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror. IPK ka siguruar numrin e operacioneve të organizuara brenda autoritetit, si tregues i performances policore në përmbushjen e objektivit të vënë. Policia Kufitare ka planifikuar, organizuar e realizuar operacione ku janë përfshirë drejtoritë dhe njësitë në kuadër të saj. Në vitin 2018 janë realizuar gjithsej 177 operacione, që paraqet numrin më të ulët të operacioneve të realizuara në tre vitet e fundit. Ky numër është për 38% më i ulët se në vitin 2015, 31% më i ulët se në vitin 2016 dhe për 41% më i ulët se në vitin 2017. Nevojitet analizimi i këtij trendi të përcjellur me rënie drastike të numrit të operacioneve, sidomos kur dihet se Qeveria e Kosovës ka aplikuar tarifën doganore për mallrat që hyjnë nga Republika e Serbisë dhe Bosnja e Hercegovina. Këto masa, përveç efektit pozitiv që mund të ndikojnë në ngritjen ekonomike, në anën tjetër shtrojnë nevojën për shtimin e masave të sigurisë, ngase mund të nxisin veprat e kundërligjshme, përfshirë edhe kontrabandën me mallra.

Tabela nr. 6 - Të dhëna mbi operacionet e organizuara brenda autoritetit (2015-2018)				
Drejtoria/Njësia	Operacione brenda autoritetit			
	2015	2016	2017	2018
Drejtoria e Operativës	27	19	31	45
Drejtoria për Migrim dhe të Huaj	0	3	3	4
Njësia e Hetimeve	14	3	4	4
Aeroporti	19	13	3	0
DRPK - Lindja	53	75	57	39
DRPK - Perëndimi	72	57	82	51
DRPK - Veriu	99	88	121	34
Gjithsej	284	258	301	177

3.2.3. Kur i referohemi bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK, është vendosur objektivi për “Ngritjen e kapaciteteve bashkëpunuese dhe bashkërenduese të autoriteteve kufitare në fushën e shkëmbimit të informacioneve, inteligjencës së përbashkët kriminale, analizave të riskut dhe parandalimit të veprave të kundërligjshme”. Në përmbushjen e objektivit të vënë është ndarë detyrë për disa akterë (Doganat e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, etj), ku është përfshirë edhe Policia Kufitare, që të hartohen plane, të krijohen ekipe dhe të realizohen operacione të përbashkëta për parandalimin dhe luftimin e veprave të kundërligjshme. IPK ka siguruar numrin e operacioneve të përbashkëta që ka realizuar Policia Kufitare me akterët e përfshirë në MIK, si një tregues i performancës policore në përmbushjen e objektivit. Në vitin 2018 janë realizuar 95 operacione të përbashkëta me autoritetet e MIK-ut, që paraqet numrin më të ulët të operacioneve të realizuara në tre vitet e fundit. Ky numër është për 44% më i ulët se në vitin 2015, për 49% më i ulët se në vitin 2016 dhe për 9% më i ulët se në vitin 2017.

Tabela nr. 7 - Të dhëna mbi operacionet e përbashkëta me autoritetet e MIK-ut (2015-2018)				
Drejtoria Njësia	Operacione të përbashkëta me autoritetet e MIK-ut			
	2015	2016	2017	2018
Dogana e Kosovës	37	47	15	25
NJSP K-9	102	103	58	29
Agjencitë tjera	10	5	9	2
Stacionet policore/Njësitë tjera	20	24	22	39
Gjithsej	169	187	104	95

3.2.4. Në rrafshin e bashkëpunimit ndërkombëtar, Plani i Veprimit ka përcaktuar përmbushjen e objektivit për shtimin e numrit të patrullimeve të përbashkëta dhe patrullimeve të sinkronizuara me autoritetet relevante të shteteve tjera. Plani Zhvillimor Strategjik lidhur me zbatimin e kontrollit e mbikëqyrjes së kufirit në përputhje me standardet e Shengenit përcakton kryerjen e patrullimeve të përbashkëta me autoritetet e MIK-ut dhe me policitë kufitare të shteteve fqinje. Ekzistojnë dhe realizohen marrëveshje për patrullime të përbashkëta me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. Për kontrollin dhe mbikëqyrjen kufitare janë arritur marrëveshje me shtetet fqinje për realizimin e patrullimeve të përbashkëta për të parandaluar aktivitetet e jashtëligjshme dhe për reagim adekuat në situata të jashtëzakonshme. Përgjithësisht vërehet trend i balancuar në tre vitet e fundit sa i përket numrit të patrullimeve të përbashkëta me policitë e vendeve fqinje. Vitet 2017 dhe 2018 konsiderohen vitet me numrin më të madh të patrullimeve të përbashkëta duke arritur shifrat prej 438, përkatësisht 430 patrullime të realizuara në vit. Numri më i madh i tyre është realizuar me Policinë Kufitare Shqiptare, kurse situata më ndryshe qëndron me patrullimet e sinkronizuara, ku në vitin 2018 nuk është evidentuar asnjë patrullim i vetëm i kësaj natyre.

Tabela nr. 8 - Të dhëna përmbledhëse mbi patrullimet e përbashkëta me policitë e shteteve fqinje												
Lloji i patrullimit	Shqipëria				Maqedonia e Veriut				Mali i Zi			
	2015	2016	2017	2018	2015	2016	2017	2018	2015	2016	2017	2018
Të përbashkëta	161	201	230	214	101	118	111	128	67	106	97	88
Të sinkronizuara	0	0	6	0	241	0	4	0	0	0	5	0

3.2.5. Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, më 2017 është nënshkruar Protokollin ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Malit të Zi, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë si dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës për krijimin dhe të funksionalizimin e Qendrës Trelaterale Kosovë-Shqipëri-Mali i Zi me seli në Plavë. Në bazë të këtij bashkëpunimi është funksionalizuar Zyra e bashkëpunimit që ka filluar të jap edhe rezultatet e para në shkëmbim informatash dhe bashkëpunim ndërkufitar. Sipas Marrëveshjes ndërshtetërore të vitit 2014, ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe asaj të Maqedonisë është hapur Qendra për Bashkëpunim Policor. Protokollet dhe marrëveshjet kanë gjetur zbatim të përbashkët, duke ruajtur bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në gjitha segmentet e patrullimeve të përziera në mbikëqyrjen e kufirit të përbashkët, kontrollin e përbashkët të kalimit të kufirit dhe shkëmbimit të informatave. Në kuadër të bashkëpunimit me Agjencinë FRONTEX⁸, zyrtarë të Departamentit për Kufi kanë marrë pjesë në takimet e zhvilluara në Varshavë. Një delegacion i kësaj Agjencie prej tre zyrtarëve kanë vizituar Departamentin për Kufi. Në kuadër të bashkëpunimit në nivelin operacional me FRONTEX-in, zyrtarë policor nga Departamenti për Kufi kanë marrë pjesë në misionin për kontrollë të kufijve të jashtëm të Shengenit dhe në aeroporte të vendeve të Shengenit.

Rekomandimi nr. 4

IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi që të analizojë trendet aktuale të performancës policore në tre nivelet e bashkëpunimit (brenda autoritetit, me akterët e MIK-ut

⁸ The European Border and Coast Guard Agency (FRONTEX) është një nga agjencitë e sigurisë së Bashkimit Europian, me detyrë ruajtjen e kufijve të jashtëm të vendeve të hapësirës Shengen, si dhe menaxhimin e flukseve migratore jo të rregullta që synojnë vendet e hapësirës. Agjencia është e specializuar në analizën e informacionit dhe të risqeve migratore të parregullta në mbështetje të rojave kufitare të vendeve, ku shtrihen kufijtë e jashtëm evropian si dhe koordinimin e tyre në mënyrë të përqendruar në menaxhim krizash migratore në tokë dhe në det.

dhe në rrafshin ndërkombëtar), në drejtim të përmbushjes së objektivave strategjike që dalin nga Plani i Veprimit të Strategjisë për Menaxhimin e Integriuar të Kufirit (me theks të veçantë të analizohen indikatorët mbi operacionet brenda autoritetit, me akterët e përfshirë në MIK dhe në rrafshin ndërkombëtar.

3.2.6. Në kuadër të strukturës së Departamentit për Kufi, analiza e vlerësimit të rrezikut bëhet në tre (3) nivele. Në nivel qendror realizohet në nivel të Departamentit dhe përfshinë analizën e vlerësimit të riskut në nivel strategjik. Në nivel rajonal, analiza e riskut realizohet në nivel të drejtorive dhe përfshinë analizën e vlerësimit të riskut në nivel operacional. Kurse, në nivelin lokal, analiza e riskut realizohet në nivel stacionesh dhe përfshinë analizën e vlerësimit të riskut në nivel taktik⁹. Të dhënat vërtetojnë se gjatë vitit 2017 dhe 2018 janë zhvilluar aktivitete në analizën dhe vlerësimin e riskut në tre nivelet e strukturës së Departamentit për Kufi. Nga niveli qendror gjatë vitit 2017 janë nxjerrë tre (3) analiza të nivelit strategjik, kurse gjatë vitit 2018 janë nxjerrë katër (4) analiza të tilla. Nga nivel rajonal gjatë vitit 2017 janë nxjerrë 48 analiza mujore, kurse gjatë vitit 2018 janë nxjerrë 16 analiza tremujore. Nga niveli lokal gjatë vitit 2017 janë nxjerrë 1.300 analiza javore, kurse gjatë vitit 2018 janë nxjerrë 312 analiza mujore¹⁰.

3.2.7. Fokus i veçantë i inspektimit ka qenë edhe vlerësimi i performances së njësive hetimore në zbulimin e krimit dhe konstatimi nëse këto njësi kanë qenë efikase në angazhimet e tyre policore në raport me objektivat që dalin nga Plani Strategjik Zhvillimor i Policisë së Kosovës (2016-2020) për luftimin e krimit dhe rritjen e zbulueshmërisë. Janë nxjerrë statistika lidhur me numrin e rasteve dhe kategorizimin e tyre. Nëse krahasojmë të dhënat statistikore në nivel Departamenti, gjatë vitit 2017 ka pasur 1.500 raste të inicuar nga vet njësitë hetimore të DRPK-ve, Sektori i Hetimeve në Departamentin për Kufi, Aeroporti, njësitë, stacionet, agjencitë dhe institucionet tjera. Ndërsa, në vitin 2018, nga e njëjta kategori e rasteve ka pasur gjithsej 1.497 sosh. Në vitin 2017, vepra penale janë kategorizuar 51% e rasteve dhe 49% janë si kundërvajtje. Në vitin 2018, 53% e rasteve janë kategorizuar vepra penale dhe 47% si kundërvajtje. Ngritje të numrit të rasteve ka shënuar DRPK-Veriu për 13%, kurse Aeroporti ka shënuar rënie të numrit të tyre për 14%. Drejtoritë tjera kanë patur shifra të balancuara të numrit të rasteve.

Tabela nr. 9 - Indikatorët e performances në parandalimin dhe luftimin e krimit ndërkufitar						
DRPK sektori	Vepra penale		Kundërvajtje		Gjithsej	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Sektori i Hetimeve (DK)	28	25	4	1	32	26
Veriu	192	195	106	143	298	338
Perëndimi	231	298	273	212	504	510
Lindja	232	201	180	203	412	404
Aeroporti	85	72	169	147	254	219
Gjithsej	768	791	732	706	1.500	1.497

⁹ PSO- Njësia e Analizës së Riskut, Intelejencës dhe Administrimin e të Dhënave.

¹⁰ Numri i raporteve të analizës dhe vlerësimit të rrezikut për vitet 2017 dhe 2018, në nivelin rajonal dhe lokal dallon përshkak se në vitin e fundit ka ndryshuar Procedura Standarde të Operimit, me ç'rast Procedura e re ka ndryshuar edhe kërkesat për raportet e analizës dhe vlerësimit të riskut.

3.2.8. IPK ka verifikuar ndërmarrjen e veprimeve hetimore nga njësitë përkatëse dhe ka përcjellur respektimin e rregullave në kompletimin e dosjeve bazuar në një varg kriteresh që burojnë nga Kodi i Procedurës Penale, Ligji për Policinë, Rregullorja për Operativë dhe Procedura Standarde e Operimit - Sektori i Hetimeve të Departamentit të Policisë Kufitare. Varësisht prej rastit të iniciuar ekzistojnë edhe procedurat për trajtimin, hetimin, kompletimin e rastit si dhe procedimin. Përpos veprimeve të veçanta që diktojnë specifikat e rastit, ekzistojnë detyrat e përgjithshme, të cilave zyrtarët policor duhet t’iu përmbahen me rastin e procedimit të rastit, të njohura si veprime fillestare¹¹. IPK ka mostruar pesë (5) dosje të Sektorit të Hetimeve në kuadër të Departamentit dhe në përgjithësi kriteret e PSO-së janë plotësuar me disa mangësi (dobësi) që janë evidentuar brenda dosjeve. Në dosjen me nr. 2017-YEK-002 ka mungesë të renditjes kronologjike të materialit në dosje. Në dosjen me nr. 2018-YA-0043 ka mungesë të fotografive të të dyshimtit dhe shenjat e gishtërinjve. Në dosjen me nr. 2018-YA-0043, tek raporti i oficerit ka munguar nënshkrimi i oficerit, tek procesverbali mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit-viktimës ka munguar nënshkrimi i policit, tek dy procesverbale të kontrollit të personit dhe banesës kanë munguar nënshkrimet e pronarit/dëshmitarit dhe nënshkrimi i policit që ka ndërmarrë veprimet e kontrollit. Në dosjen me nr. 2018-YI-01, tek raporti fillestar i incidentit ka munguar nënshkrimi i oficerit dhe mbikëqyrësit, tek procesverbali mbi kontrollin e personit dhe banesës ka munguar nënshkrimi i oficerit/pronarit dhe dëshmitarit, kanë munguar fotografitë e të dyshuarve dhe shenjat e gishtërinjëve. Në dosjen nr. 2018-YNB-012 kanë munguar fotografitë e të dyshuarve, shenjat e gishtërinjëve dhe fotografia e dëshmisë. Moskompletimi i këtyre dosjeve është rezultat i neglizhencës dhe kjo praktikë duhet eliminuar ngase nuk i kontribuon profesionalizmit dhe ndikon në kualitetin e hetimit dhe dosjes.

Rekomandimi nr. 5

IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Sektorit të Hetimeve të Departamentit për Kufi që në të ardhmen të ushtrojë kontroll të shtuar mbi varëtishtë në mënyrë që dosjet hetimore të mirëmbahen dhe të jenë të plota me tërë dokumentacionin e nevojshëm, ashtu siç parashihet me Procedurën Standarde të Operimit - Sektori i Hetimeve të Departamentit të Policisë Kufitare.

3.3. Mbikëqyrja dhe kontrollimi i shtetasve të huaj në territorin e vendit

3.3.1. Gjatë këtij inspektimi është vlerësuar respektimi i rregullave dhe procedurës gjatë refuzimit të hyrje-daljeve në kufi të shtetasve të huaj, siç parashihet me Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 24/2013 për refuzimin e hyrjes në Republikën e Kosovës. Në bazë të këtij Udhëzimi, Policia ka autorizime që të refuzojë hyrjen e personave në PKK kur përmbushen kriteret e përcaktuara për refuzim të hyrjes në Republikën e Kosovës që lidhet me nenet 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9. Policia Kufitare gjatë vitit 2017 e 2018 është ballafaquar me numër të konsideruar të rasteve që lidhen me refuzime të hyrje-daljeve të personave gjatë kalimit kufitar. Viti 2017 ka evidentuar gjithsej 3.985 refuzime të hyrje-daljeve të personave, derisa viti 2018 ka evidentuar 2.954 sosh (26% më pak se një vit më parë). Arsyet më të shpeshta për refuzim kryesisht kanë qenë: mungesa e dokumenteve, mungesa e vizës hyrëse, mungesa e mjeteve të nevojshme për të qëndruar në Republikën e Kosovës dhe mungesa e dokumenteve të vlefshme. Për çdo rast të refuzimit plotësohet formulari adekuat, një kopje e të cilit i jepet palës ku njoftohet me arsyen e refuzimit dhe udhëzohet për mundësinë e

¹¹ Veprimet fillestare përfshijnë: sigurimin e vendit të ngjarjes, sigurimin e dëshmitarëve dhe dëshmitarëve, raportin fillestar të incidentit me numër të rastit, deklaratat e personave të përfshirë, raportet e policëve, zinxhirin e ruajtjes, raportin e shpejtë kur kërkohet përmes Qendrës Operative.

parashtrimin të ankesës dhe një kopje mbetet në Polici Kufitare. IPK vlerëson se veprimet policore për refuzimin e hyrjes së personave të huaj në territorin e vendit tonë janë në harmoni të plotë me Udhëzimin në fjalë. Inspektorët kanë verifikuar nëse ndonjë shtetas i huaj të cilit i është refuzuar hyrja në territorin e vendit tonë është evidentuar në bazat e të dhënave kufitare. Nga intervistat e realizuara dhe të dhënat tjera të siguruara nuk është arritur të evidentohet ndonjë rast kur të huajit i është lejuar hyrja në vendin tonë pa i përmbushur kriteret e cekura me Ligjin në fjalë.

3.3.2. Për të vlerësuar veprimet gjatë procedurës së largimit të shtetasve të huaj nga territori i vendit tonë, IPK-ja ka marrë parasysh Ligjin për të Huajt dhe Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për kthimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në Republikën e Kosovës, të cilat rregullojnë standardet dhe procedurat për kthimin e të huajve që nuk përmbushin kushtet ligjore për qëndrim në vendin tonë, përfshirë edhe kthimin vullnetar. Evidenca e personave të deportuar me urdhër të gjykatës pasqyron se gjatë vitit 2018 ka pasur ngritje të numrit të deportimeve të shtetasve të huaj për 20% krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2018 ka ngritje për 55% të kërkesave për urdhërlargim. Kurse, numri i urdhërlargimeve të ekzekutuara në vitin 2018 është më i lartë për 6% krahasuar me një vit më parë. IPK-ja ka analizuar dhe verifikuar kryerjen e detyrave konform Procedurës së Njesisë së Deportimeve në kuadër të DMH-së. Janë kontrolluar 16 dosje të deportimeve të vitit 2017 e 2018. Katër (4) dosje të deportimeve (68/2017, 148/2018, 157/2018, 27/2018, 31/2018) nuk kanë patur të bashkëngjitur Aktvendimin/aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës kompetente. Të gjitha dosjet kanë patur kërkesat për ekzekutimin e deportimit, si dhe kërkesën drejtuar DSHAM-it për sigurimin e biletës së udhëtimit, nëse kjo është e nevojshme. Dosja nr. 55/2018 nuk ka patur kërkesën drejtuar DSHAM-it për sigurimin e fletëudhëtimit për të huajin (në rast kur i huaji nuk ka pasaportë a dokument udhëtimi). Në gjashtë (6) dosje (08/2017, 008/2017, 68/2017, 148/2018, 157/2018 dhe 27/2018) është evidentuar mungesa e vlerësimit të rrezikut. Në të gjitha dosjet e depërtimeve është evidentuar mungesa e kopjes së ushtruesit të kallëzimit penal/fletëparaqitjes së rastit me të gjitha shkresat përcjellëse për kompletimin e rastit. Në të gjitha dosjet është evidentuar mungesa e formularit standard për gjurmë të gishtërinjëve. Në të gjitha dosjet është evidentuar mungesa e fotografive të personit të deportuar. Në dy (2) dosje (841/2017 dhe 008/2017) nuk është bashkëngjitur kopja e dokumentit të udhëtimit, pasaportës, fletudhëtimit për të huaj apo ndonjë dokument tjetër identifikues që posedon personi i dëbuar. Në një (1) dosje (3386/18) nuk është bashkëngjitur procesverbali i deportimit. Në katër (4) dosje (08/2017, 3386/18, 55/2018 dhe 87/2018) ka munguar njoftimi dhe dorëzimi i personit që dëbohet tek zyrtari i kompanisë që i është aranzhuar udhëtimi. Në dy dosje (55/2018 dhe 3386/2018) ka munguar raporti i policit lidhur me deportimin. Në të gjitha dosjet ka munguar raporti i shpejtë për rastin që kompletohet pas ekzekutimit të deportimit. Në 14 dosje të deportimeve (08/17, 779/17, 841/17, 210/2017, 234/2017, 008/2017, 68/2017, 19/2018, 55/2018, 3386/18, 87/2018, 148/2018, 157/2018 dhe 27/2018) ka munguar dëshmia mbi futjen e të dhënave në sistemin PISCE/BMS. Moskompletimi i dosjeve ndikon negativisht në efektivitetin e kryerjes së detyrave dhe kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mosangazhimit efektiv të personelit të njësive përkatëse.

Rekomandimi nr. 6

IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj që të ushtrojë kontroll të shtuar mbi vartësit në respektimin e procedurave dhe rregullave për largimin (deportimin) e të huajve nga territori i vendit tonë dhe mirëmbajtjen e dosjeve siç parashihet me kriteret e vëna me Procedurat e Njesisë së Deportimeve.

3.3.3. Lëshimi i vizave në PKK është përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit viza lëshohet nga misionet diplomatike apo konsullore të Republikës së Kosovës (neni 3 i Udhëzimit Administrativ nr. 08/2014). Neni 4 i këtij Udhëzimi ka përcaktuar kriteret që duhet të plotësohen për lëshimin e vizës për të huajt në PKK. Shtetasit e huaj për t'u pajisur me vizë në PKK duhet të kenë dokument të vlefshëm udhëtimi, të arsyetojnë qëllimin dhe kushtet e qëndrimit, duhet të kenë mjete të mjaftueshme për jetesë, nuk duhet të kenë ndalesë të hyrjes dhe qëndrimit në vendin tonë, nuk duhet të paraqesin kërcënim për sigurinë shtetërore, rendin publik, shëndetin publik ose marrëdhëniet e vendit tonë me shtetet tjera. Parashihet se shtetasi i huaj mund të pajiset me vizë edhe për arsye se nuk ka qenë në gjendje të parashtojë kërkesë për vizë paraprakisht dhe të dorëzojë dëshmi të ekzistimit të arsyeve të paparashikueshme dhe të domosdoshme për hyrje. Policia Kufitare në PKK gjatë vitit 2017 ka lëshuar 16 viza për shtetasit që kanë pasur destinim hyrjen në territorin e Republikës së Kosovës, kurse në vitin 2018 po ashtu janë lëshuar 16 viza për raste të kësaj natyre. IPK ka vërejtur se mbahet Evidenca mbi vizat e lëshuara në PKK dhe ka patur në dispozicion për inspektim dhjetë (10) dosje të lëshimit të vizave në PKK. IPK-ja nuk ka hasur në parregullësi lidhur me respektimin e procedurave dhe rregullave për dhënien e vizave në PKK.

3.3.4. Përveç autorizimeve që ka për lëshim të vizave në PKK, Policia Kufitare ka autorizime të kryejë disa veprime edhe lidhur me dhënien e vizave për të huajt nga misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. DMH kryen verifikimin e sigurisë për aplikuesit e vizave në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës dhe atë për vizën C, si vizë turistike dhe vizën D, si vizë e punës. MPJ i parashtron kërkesë DMH-së për verifikimin e gjendjes faktike lidhur me garantuesin dhe aplikuesin për vizë. Verifikimi bëhet me qëllim të zbatimit të Ligjit për të Huajt në funksion të parandalimit e luftimit të migracionit të paligjshëm¹². Verifikimi realizohet duke verifikuar evidenca nga bazat e të dhënave, si: Europol, ILECU¹³, Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë (DIA), Drejtoria Kundër Terrorizmit, Stop Lista, Baza e të dhënave për urdhërlargimet, SIPK-u, Baza e të dhënave të garancioneve dhe SMK-ja. Pas verifikimit, përgjigjja kthehet prapë përmes sistemit të vizave SIVK dhe DSHAM-it për vizën e punës D, sepse kjo vizë jepet për të marrë lejeqëndrim shtetasi i huaj. IPK-ja ka vlerësuar respektimin e procedurës dhe rregullave për verifikimin e aplikantëve për viza siç parashihet në kapitullin II, pikat nga 1-6 të PSO-së. Lidhur më këtë janë kontrolluar tre (3) dosje të vitit 2017 dhe tre (3) të vitit 2018. Lidhur me verifikimin e aplikuesve të vizave dhe procedimin e dhënies së tyre, bazuar në mostrat e kontrolluara, IPK-ja vlerëson se pas kërkesave të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës, DMH ka respektuar kriteret e përcaktuara konform PSO-së. Dosjet kanë kërkesat për verifikim të aplikantëve dhe raportet e verifikimit. Këto të fundit i kthehen me kohë MPJ-së përmes DSHAM-it. Pasqyrohet ngritje e numrit të verifikimeve për 6%, derisa numri i verifikimeve me rekomandim negativ për dhënie të vizave është ulur nga 32% sa ishte në vitin 2017, në 13% në vitin 2018.

Tabela nr. 10- Të dhëna mbi aktivitetet e DMH-së në verifikimin e kërkesave për pajisje me viza			
Aktiviteti	2017	2018	%
Kërkesa të verifikuara për viza	1.179	1.246	6
Verifikimi me rekomandim pozitiv për viza	719	917	28
Verifikimi me rekomandim negativ për viza	80	165	106
Verifikimi me rekomandim neutral për viza	380	164	-57

¹² Procedura Standarde e Operimit - Verifikimi i aplikantëve për viza, nr. refereues DDK-05/004/2014).

¹³ International Law Enforcement Coordination Unit (ILECU).

3.3.5. IPK gjatë inspektimit është interesuar edhe për respektimin e procedurave, rregullave gjatë trajtimit fillestar të azilkërkuesve siç përcaktohen në Procedurën Standarde të Operimit - Trajtimi fillestar i azilkërkuesve (DDK-05/003/2014), kapitulli IV, pikat 1-5. Procedura e përgjithshme në trajtimin e azilkërkuesve fillon kur shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi paraqet kërkesën për azil. Kërkesa e azilit paraqitet në momentin e hyrjes në Kosovë, në një PKK, në një stacion policor ose DSHAM. Trajtimi fillestar për azilkërkues ndërmerret nga zyrtarët e Njësisë për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Sektorit për Operativë. Fillimisht azilkërkuesve u jepet udhëzuesi mbi të drejtat e tij, u ofrohet ndihma e parë mjekësore, u ofrohet përkthimi, ushqimi nëse paraqitet nevoja, u bëhet verifikimi i identitetit dhe i të kaluarës, intervistimi- plotësimi i pyetësorit, marrja e gjurmëve të gishtërinjve, fotografimi, plotësimi i formularit për azilkërkues. Pas kompletimit të këtij procesi, azilkërkuesi dorëzohet në Qendrën e Azilkërkuesve. Dosjet e kompletuara dorëzohen brenda tre (3) ditëve të punës në Qendrën e Azilit dhe si të tilla kalojnë në procedurë të mëtejme të shqyrtimit në DSHAM. Për respektimin e procedurave, rregullave gjatë trajtimit fillestar të azilkërkuesve janë inspektuar gjashtë (6) dosje të vitit 2017 e 2018. Gjatë inspektimit të dosjeve është vlerësuar se janë respektuar kriteret sipas PSO-së. Dosjet përmbajnë kërkesën për azil, bashkë me dokumentet përkatëse si: formularin fillestar, gjurmët e gishtërinjëve, fotografitë, mjetet e provës, dokumentet e identitetit, si dhe dokumente tjera të dorëzuara nga azilkërkuesit.

3.4. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe teknike

3.4.1. Policia konsiderohet si organizatë komplekse, dinamike dhe e ekspozuar ndaj ndryshimeve strukturore dhe lëvizjeve të burimeve njerëzore brenda strukturës. Fokus inspektimi kanë qenë dhe kapacitetet njerëzore për kontroll dhe mbikëqyrje të kufirit, siç përcaktohet me Rregulloren mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës. Janë krahasuar kapacitetet aktuale të burimeve njerëzore me kapacitetet e parashikuara me organogramin në fuqi. Me gjithë faktin se është duke u stabilizuar organizimi struktural me burimet njerëzore, ende vërehen disa tejkalime dhe mungesa në kuadër të këtyre kapaciteteve. Në kuadër të Departamentit për Kufi ka një shpërputhje të numrit të pozitive të parapara sipas strukturës (28.02.2019) krahasuar me gjendjen aktuale. Departamenti në tërë strukturën e shpërndarë në nivel qendror, rajonal dhe lokal ka momentalisht të angazhuar 1.273 punonjës, përfshirë personelin e uniformuar dhe shërbyesit civil. Struktura ka të përcaktuar numrin prej 1.268 punonjësve. Krahasimi i kapaciteteve vë në pah tejkalim të numrit të majorëve, të rreshterëve dhe të policëve, derisa mungesat vërehen në numrin e kolonelëve, nënkolonelëve, kapitenëve, togerëve e shërbyesve civil. Mospërputhja është rezultat i lëvizjeve dhe ndryshimeve dinamike brenda organizatës dhe mosmenaxhimit efektiv të shpërndarjes së burimeve njerëzore karshi ndryshimeve. Në disa drejtori, disa pozita të përcaktuara më gradë më të lartë ushtrohen nga punonjës me grada më të ulëta, si dhe anasjelltas. Divizioni për Kontrollë dhe Mbikëqyrje të Kufirit udhëhiqet nga një nënkolonel edhe pse parashihet të udhëhiqet nga një kolonel. DMH parashihet të udhëhiqet nga një nënkolonel, tani udhëhiqet nga një kolonel. Departamenti duhet të sistemojë personelin e graduar në pozita përkatëse dhe duhet eliminuar mospërputhjen e pozitive me gradat.

Tabela nr. 11 - Të dhëna përmbledhëse mbi kapacitetet e burimeve njerëzore (qershor 2019)											
Departam.	Kapacitetet e burimeve njerëzore sipas gradave										
	Drejtor	Kol.	N/kol.	Maj.	Kap.	Tog.	Rresh	Polic	SHC	Total	
Struktura	1	5	7	7	26	30	160	990	42	1.268	
Aktuale	1	4	5	8	23	27	165	1003	37	1.273	
Ndryshimi	0	-1	-2	+1	-3	-3	+5	+13	-5	+5	

3.4.2. Përveç tjerave, fokus ishte edhe shpërndarja e personelit të graduar në kuadër të strukturës së Departamentit për Kufi. Janë siguruar të dhëna mbi sistemimin dhe shpërndarjen e personelit të graduar dhe janë krahasuar sistemimet e tilla me pozitat. Në përgjithësi në DRPK ka shpërputhje të numrit të aprovuar me gjendjen aktuale në nivel rajonal e lokal. Në kuadër të DRPK-Perëndimi janë paraparë 347 punonjës, përfshirë edhe stafin civil, ndërsa janë të angazhuar 351 punonjës. Në këtë Drejtori, në njërin anë shfaqet mungesë e një (1) nënkoloneli, dy (2) togerëve dhe dy (2) shërbyesve civil, ndërsa ka katër (4) rreshter dhe pesë (5) polic më tepër. Në kuadër të DRPK-Veriu janë paraparë 376 punonjës, përfshirë edhe stafin civil, ndërsa janë të angazhuar 371 punonjës. Në kuadër të kësaj Drejtorie ka mungesë të një (1) nënkoloneli, një (1) kapiteni, dy (2) rreshterëve dhe një (1) shërbyesi civil, ndërsa ka shtatë (7) polic më tepër. Në kuadër të DRPK-Lindje janë paraparë 387 zyrtarë përfshirë edhe stafin civil ndërsa janë të angazhuar 390 punonjës. Ka mungesë të një (1) koloneli, dy (2) kapitenëve, katër (4) rreshterëve dhe një (1) shërbyesi civil, ndërsa ka tre (3) toger e shtatë (7) polic më tepër. Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mosmenaxhimit efektiv të procesit të shpërndarjes së burimeve njerëzore.

3.4.3. Në kuadër të gjitha DRPK-ve, përveç mospërputhjes sasiore të kapaciteteve, shfaqet edhe dukuria kur në kuadër të strukturave të tyre, pozitat e përcaktuara më gradë më të lartë ushtrohen nga të graduar me grada më të ulëta dhe anasjelltas. Në DRPK-Perëndimi (SPMK-Dragash), pozita e Shefit të Sektorit të Operativës ushtrohet nga një rreshter¹⁴, derisa me strukturë për këtë pozitë është paraparë grada toger. Në DRPK-Veriu, pozita e Komandantit të SPMK-Leposaviq ushtrohet nga një toger, derisa me strukturë për këtë pozitë është paraparë grada kapiten, mandej pozita e Mbikëqyrësit të Ekipit ushtrohet nga një toger, derisa me strukturë për këtë pozitë është e paraparë grada rreshter, si dhe pozita e Zyrtarit për burime njerëzore ushtrohet nga një zyrtar policor, derisa për këtë pozitë është paraparë grada rreshter. Në DRPK-Lindje, pozita e Këshilltarit të Drejtorit Rajonal ushtrohet nga një major, derisa parashihet grada nënkolonel, pozita e Mbikëqyrësit të Ekipit ushtrohet nga një toger, derisa parashihet grada rreshter dhe pozita e Zyrtarit për burime njerëzore ushtrohet nga një zyrtar policor, derisa me strukturë parashihet grada rreshter. IPK-ja vlerëson se burimet njerëzore në Departamentin për Kufi janë të mjaftueshme për realizimin e vizionit dhe misionit, por shprehë shqetësimin me shpërputhjen me numrin e aprovuar të burimeve, e cila mund të ndikoj në efektivitetin dhe performancën e DRPK-ve dhe Departamentit për Kufi në përgjithësi.

Rekomandimi nr. 7

IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi që në bashkëpunim me Drejtorin e Drejtorisë së Personelit të ndërmarrin veprimet konkrete drejt vendosjes dhe shpërndarjes së burimeve njerëzore në pajtim me strukturën e aprovuar, duke i kushtuar kujdesin e duhur shpërndarjes sasiore sipas numrit dhe gradave.

3.4.4. Avancimi i njohurive dhe shkathtësive përmes programeve trajnuese ndikon në ngritjen e efikasitetit dhe performancës së burimeve njerëzore. Avancimi i njohurive të burimeve njerëzore policore kufitare përmes programeve trajnuese dhe trajnimeve të brendshme është paraparë me Rregulloren për Personel dhe Administratë (Trajnimet e brendshme), ku përcaktohet se “Njësitë organizative në kuadër të Policisë, Divizionet, Drejtoritë në Departamentin për Shërbime Mbështetëse, Drejtoritë Rajonale duhet të përkujdesen që secili zyrtar policor i kësaj drejtorie,

¹⁴ Vendimi nga Drejtoria e Personelit si Ushtues Detyre i Shefit të Operativës në SPMK- Dragash.

brenda periudhës kohore prej një (1) viti t'i mbajë së paku 40 orë trajnim". Bazuar në raportet mbi trajnimet e brendshme dhe duke i krahasuar trendet e viteve të fundit, në përgjithësi është vlerësuar se ka pasur përmbushje të kënaqshme të kuotës së përcaktuar për vijueshmërinë në trajnimet e brendshme. Lidhur me përmbushjen e kuotës, gjatë vitit 2017 DRPK-Lindja ka përmbushur planin prej 100% të pjesëmarrjes së personelit, pasuar nga DRPK-Perëndimi me 99% dhe Aeroporti me 97% të personelit të përfshirë në trajnime. Kurse, shkallë më të ulët të vijueshmërisë në trajnimet e brendshme ka realizuar DRPK-Veriu me 55%. Gjatë vitit 2018, DRPK-Lindja ka përmbushur planin prej 100% të pjesëmarrjes së personelit në trajnime, pasuar nga DRPK-Perëndimi me 99% dhe Aeroporti me 97%. Shkallë më të ulët të vijueshmërisë në trajnimet e brendshme, por me një ngritje më të theksuar krahasuar me vitin 2017, ka realizuar DRPK-Veriu me 88%. IPK-ja çmon angazhimin dhe përkushtimin e drejtuesve të DRPK-Lindja, DRPK-Perëndimi dhe Aeroporti për përmbushje të kuotës së përcaktuar për vijueshmërinë në trajnime të brendshme dhe nxitë drejtuesit e DRPK-Veriu që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për ngritjen e kuotës për vijueshmërinë në trajnime të brendshme.

3.4.5. Rregullorja për Personel dhe Administratë ka përcaktuar se të gjithë zyrtarët policorë, pa marrë parasysh nivelin dhe gradën policore janë të obliguar që brenda periudhës kohore prej çdo 12 deri në 18 muaj ta vijnë trajnimin për ricertifikim. Ricertifikimi ka për qëllim që të gjithë zyrtarët policor përmes këtij procesi t'i ripërsërisin dhe t'i rifreskojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre policore, në mënyrë që të jenë sa më efikas dhe profesional në kryerjen e punëve policore. Raportet vjetore të DRPK-ve mbi trajnimet e ricertifikimit pasqyrojnë se gjatë vitit 2017 dominon DRPK-Perëndimi me 99.7%, pasuar nga Aeroporti me 69% vijueshmëri dhe DRPK-Lindje me 40% vijueshmëri të personelit, kurse DRPK-Veriu përfaqësohet me 30% vijueshmëri të personelit në ricertifikim. Në vitin 2018 vërehet rënie e nivelit të vijueshmërisë, ku DRPK-Perëndimi përfaqësohet me 48.4%, DRPK-Veriu me 48%, Aeroporti me 45% dhe DRPK-Lindje me 33.8%. IPK vlerëson se kjo rënie e nivelit të vijueshmërisë së trajnimit të ricertifikimit ndikon negativisht në avancimin e njohurive e shkathtësive të burimeve njerëzore dhe kryerjen efikase e profesionale të punëve policore.

Rekomandimi nr. 8

IPK-ja u rekomandon drejtuesve të Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare që në bashkëpunim me Divizionin e Trajnimeve të ndërmarrin veprimet e nevojshme për përfshirjen e zyrtarëve policor në trajnimin e ricertifikimit konform afateve të përcaktuara me Rregulloren për Personel e Administratë, në drejtim të ripërsëritjes dhe rifreskimit të njohurive dhe shkathtësive policore.

3.4.6. Në gamën e aktiviteteve në fushën e parandalimit dhe luftimit të dukurive korruptive në kuadër të strukturave të policisë kufitare, fokus i veçantë i është kushtuar zhvillimit dhe vënies në zbatim të masave anti-korrupsion. Synimi i Strategjisë Anti-Korrupsion është ruajtja e shëndetit dhe integritetit policor. Gjatë këtij inspektimi janë siguruar informata mbi hapat e Departamentit në lëvizjen e personelit në drejtim të implementimit të Strategjisë Anti-Korrupsion. Vërehet se i kushtohet kujdes i veçantë implementimit të kësaj Strategjie dhe janë evidentuar hapat konkret. Janë evidentuar rastet kur janë bërë ndryshimet në pozitat kyçe menaxheriale. Në kuadër të DRPK-ve është bërë lëvizja e personelit menaxherial, duke vendosur drejtor të rinjë në pozita drejtuese në përjashtim të DRPK-Veriu, ndërsa në nivelin lokal të stacioneve janë vendosur komandantë të rinjë në të gjitha SPK-të (A) si dhe SPMK-të. Drejtorët e DRPK-ve, komandantët e SPK/SPMK-

ve me kohë janë informuar me Strategjinë dhe detyrat në zbatimin e saj. Në SPK/SPMK gjatë brifingjeve me njësitë dhe ekipet është diskutuar mbi implementimin e Strategjisë dhe janë lëvizur policët nga një ekip në tjetrin. Inspektimi nxorri në pah se implementimi i Strategjisë ka prekur edhe nivelet e larta udhëheqëse, gjë e cila në inspektimin e kaluar nuk ishte e mjaftueshme. IPK-ja çmon këto veprime të Departamentit për Kufi dhe inkurajon që të vazhdohet edhe më tutje në implementimin e Strategjisë Anti-Korrupsion, me qëllim që personeli të jetë rezistent ndaj dukurive negative që mund ta prekin atë.

3.4.7. Realizimi i inspektimeve për kontrollin e kualitetit në drejtim të verifikimit në praktikë të zbatimit të Planit të punës, arritjen e qëllimeve dhe objektivave, si dhe identifikimin e pengesave apo vështirësive në zbatimin e Planit të punës parashihet në kapitullin III, pika 2, 3, 4 dhe 5 të Procedurës Standarde të Operimit - Kontrolli i kualitetit¹⁵. Qëllimi i kontrollit të kualitetit nga menaxhmenti është verifikimi në praktikë i zbatimit të planit të punës, duke matur indikatorët kyç në përmbushjen e objektivave. Raportet e kontrollit të kualitetit kanë identifikuar sfida dhe pengesa në zbatimin e planit të punës. Ekipet kanë bërë kontrole të planifikuara dhe të kohëpaskohshme dhe ato tregojnë sfida dhe pengesa gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përfshirë burimet njerëzore, objektet, pajisjet, respektimin e orarit, mirëmbajtjen dhe furnizimin me pajisje, etj. Nuk vërehet se inspektimet e tilla kanë prekur sa duhet hetimet, duke dhënë përshtypjen e një kontrolli jo cilësor. Duhet ngritur kualitetin e kontroleve duke analizuar fillimisht metodat se si është kryer puna dhe epilogu i rasteve hetimore në përgjithësi. Ekipi i kontrollit duhet të zbatojë në tërësi metodologjinë e inspektimit në zbatimin cilësor të kontrollit kufitar. Nuk duhet anashkaluar pikat e ndjeshme, siç janë hetimet. Në SPK-Jarinje nuk është bërë asnjë inspektim. Duke pasur parasysh se kontrollet shërbejnë për të mirën e institucionit dhe qytetarëve, presim që në të ardhmen të ketë kontrole më efikase me qëllim të zbatimit të ligjit dhe në funksion të parandalimit të shkelësve të ligjit.

Rekomandimi nr. 9

IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi dhe drejtuesve të drejtorive dhe stacioneve policore që në të ardhmen të ngrisin nivelin e kontrollit të kualitetit, duke praktikuar metodologjinë e inspektimit apo kontrollit në rajonet e tyre siç e përcakton Procedura Standarde e Operimit - Kontrolli i kualitetit, në mënyrë që kontrollet të jenë më cilësore dhe të prekin fushat e ndjeshme.

3.4.8. Kontrollit-mbikëqyrjes së vijes kufitare i kontribuon edhe avansimi i kapaciteteve teknike dhe teknologjike. Departamenti për Kufi ka vendosur në pjesë të caktuara përgjatë vijës kufitare sistemin e monitorimit me kamera. Inspektorët kanë inspektuar sistemin e tillë dhe kanë verifikuar respektimin e rregullave për vendosjen e kamerave, monitorimin dhe funksionalitetin e tyre, siç parashihet në kapitullin III, pika 2 dhe 3 të Procedurës Standarde të Operimit - Kamerate për mbikëqyrjen e kufirit tokësor/ujor¹⁶. Janë siguruar informata nga drejtues të SPMK-ve dhe është inspektuar vendosja e kamerave, pozicionimi, funksionimi, si dhe mirëmbajtja e tyre. IPK-ja gjatë inspektimit të pajisjeve të nevojshme në fushën e kontrollimit dhe mbikëqyrjes së kufirit ka gjetur se SPMK-të kanë pajisje të mjaftueshme për arritjen e qëllimeve dhe se në Departament po punohet vazhdimisht që këto pajisje të avancohen në pajtim me zhvillimet teknologjike. Departamenti ka pajisur SPMK-të me kamera vëzhguese, si donacion nga Programi EXBS. Në bazë të analizës së

¹⁵ Departamenti për Kufi, *PSO - Kontrolli i kualitetit*, DDK-05/009/14, datë 30.04.2014.

¹⁶ Departamenti për Kufi, *PSO - Kamerate për mbikëqyrjen e kufirit tokësor/ujor*, DDK-05/003-2014, datë 04.07.2014

riskut dhe nevojave operative, kamerat vëzhguese praktikohet të vendosen në vende të mundshme të zhvillimit të kimit ndërkufitar. Këto pajisje janë funksionale por në disa raste shfaqen vështirësi të vendosjes së tyre për shkak të ambientit dhe pozitës gjeografike që përshkojnë zonat kufitare. Kamerat janë të instaluar përgjatë vijës kufitare që e kontrollojnë DRPK-të dhe mbikëqyren nga SPMK-të. Kamerat funksionojnë duke shkrepur fotografi apo regjistrojnë video me ndihmën e sensorit dhe materialet e regjistruara dërgohen automatikisht përmes SIM-kartelës në e-mail në adresat e paracaktuara. Në kuadër të zonës që kontrollojnë SPMK-Keqekollë e Kërpimeh, kamerat vëzhguese janë jashtë funksioni për shkaqe teknike të konfigurimit. IPK vlerëson se menaxhimi i kamerave për mbikëqyrje të kufirit tokësor/ujor është në harmoni me PSO-në dhe pajisja e njërive me kamera dhe pajisje tjera ndikon pozitivisht në ngritjen e kualitetit të kryerjes së detyrave.

3.4.9. Një ndër faktorët e rëndësishëm për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit janë pajisjet dhe mjetet e punës së njërive patrulluese. IPK-ja është fokusuar në vlerësimin e nivelit të pajisjes së njërive patrulluese me mjete dhe pajisje të nevojshme siç parashihet në kapitullin IV, pika 5 të Procedurës Standarde të Operimit - Standardet e Mbikëqyrjes së Kufirit¹⁷. Janë inspektuar patrullat kufitare të rastit. Më 01.07.2019 në kuadër të DRPK-Lindje është inspektuar patrulla kufitare nga ndërrimi A i SPMK-Zhegër dhe më 02.07.2019 është inspektuar patrulla kufitare nga ndërrimi C i SPMK-Gjilan. Më 04.07.2019 në kuadër të DRPK-Perëndimi është inspektuar patrulla nga ndërrimi A i SPMK-Ponoshec dhe më 05.07.2019 është inspektuar patrulla kufitare nga ndërrimi D i SPMK-Vitomiricë. Më 25.06.2019 në kuadër të DRPK-Veriu është inspektuar patrulla nga ndërrimi A i SPMK-Kërpimeh dhe më 09.07.2019 është inspektuar patrulla kufitare nga ndërrimi (..) i SPMK-Keqekollë. Inspektimi i patrullave nxorri në pah disa vështirësi dhe mungesa evidente lidhur me pajisjet për punë. Automjetet zyrtare të pesë (5) patrullave kufitare (Zhegër, Gjilan, Ponoshec, Vitomiricë, Keqekollë) kanë pasur gjendje jo të mirë teknike dhe mungesë të pajisjeve përcjellëse të nevojshme, si të sistemit të radio komunikimit, rrjetës mbështjellëse kamuflazhi për automjet, pengesave për ndaljen e dhunshme të automjeteve dhe pajisjeve të ndihmës së parë. Në dy (2) patrulla (Zhegër, Ponoshec) është evidentuar mungesa e armëve të gjata. Në katër (4) patrulla (Zhegër, Gjilan, Ponoshec, Keqekollë) janë evidentuar mungesa të uniformës kamuflazhë. Në dy (2) patrulla kufitare (Kërpimeh dhe Keqekollë) janë evidentuar mungesa apo gjendje jofunksionale të kamerave vëzhguese. Në katër (4) patrulla kufitare (Gjilan, Vitomiricë, Kërpimeh, Keqekollë) janë evidentuar mungesa apo radiolidhje jofunksionale. Në katër (4) patrulla (Zhegër, Ponoshec, Vitomiricë dhe Keqekollë) janë evidentuar mungesa të hartave. Në patrullën e SPMK-Zhegër është evidentuar mungesa e jelekut antiplumb. Në patrullën e SPMK-Keqekollë është evidentuar mungesa e GPS-it. Në patrullën e SPMK-Ponoshec është evidentuar mungesa e bllokut për shënim të kundërvajtjeve. IPK shprehë shqetësimin lidhur me mungesat dhe funksionalitetin e pajisjeve të patrullave dhe automjeteve dhe kjo ndikon në efikasitetin dhe performancën e tyre.

3.4.10. Bazuar në inspektimin e realizuar në DRPK, inspektimi nxorri në pah disa vështirësi dhe mungesa evidente lidhur me pajisjet e nevojshme për punë. DRPK-të ballafaqohen me numër të pamjaftueshëm të automjeteve dhe shumica prej tyre nuk janë funksionale. Mungesa e automjeteve patrulluese dhe defektet e shpeshta bëjnë që me muaj të tërë automjetet me defekte të qëndrojnë në Flotë duke mbetur kështu jashtë përdorimit operacional. Shumica prej automjeteve zyrtare janë më të vjetra se dhjetë (10) vite dhe kanë shumë kilometra të kaluara. Kjo gjendje ndikon shumë në

¹⁷ Departamenti për Kufi, PSO - Standardet e Mbikëqyrjes së Kufirit, DDK-05/308/15, datë 04.05.2015.

efikasitetin e patrullave në mbulimin efikas të zonës së përgjegjësisë. DRPK-të veç mungesës së automjeteve ballafaqohen me mungesa edhe të pajisjeve tjera, si: sistemi i radio komunikimit, radiolidhjeve, rrjetave mbështjellëse kamuflazhi për automjete, pengesave për ndaljen e dhunshme të automjeteve dhe pajisjeve të ndihmës së parë (ka prej tyre me afat të skaduar), etj. Mungesat dhe gjendja jofunksionale e pajisjeve të nevojshme për aktivitete të policimit kufitar ndikojnë dukshëm në efikasitetin dhe performancën e patrullave në kryerjen e detyrave policore. Po ashtu, kompletimi me pajisje sipas kriterëve të kërkuara do të ndikonte në ruajtjen e shëndetit të zyrtarëve policor të SPMK-ve në fushën e kontrollimit dhe mbikëqyrjes së kufirit. Veç tjerash, IPK është fokusuar edhe në inspektimin dhe vlerësimin e pajisjeve në SPK-të të kategorisë A, që janë të nevojshme për kontrollin kufitar të vijes së parë dhe të dytë. Sa i përket vlerësimit të pajisjeve teknike në SPK-të, IPK-ja bazuar në kapitullin IV, pika 2 të PSO-së vlerëson se në SPK-Jarinje (DRPK-Veriu) ka mungesë të pajisjes terminal portabël, në SPK- Dheu i Bardhë (DRPK-Lindje) dhe SPK-Merdare (DRPK-Veriu) fibroskopi është jofunksional dhe në Aeroport ka mungesë të çantës së pajisjeve CT30. IPK-ja vlerëson pajimin e SPK-ve me pajisje të nevojshme për punët policore në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, por njëherit shprehë dhe shqetësim për mungesat dhe jofunksionalitetin e tyre. IPK-ja vlerëson se këto mungesa dhe mosfunksionaliteti i pajisjeve ndikojnë në performancën e stacioneve në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit.

Rekomandimi nr. 10

IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi që në bashkëpunim me Drejtorin e Departamentit për Shërbime Mbështetëse të ndërmarrë veprimet e nevojshme për pajimin e Stacioneve Policore të Mbikëqyrjes së Kufirit me automjete dhe pajisje për patrullim kufitar në pajtim me Procedurën Standarde të Operimit - Standardet e Mbikëqyrjes së Kufirit, si dhe pajimin e Stacioneve Policore Kufitare me pajisje të nevojshme të kontrollit kufitar në pajtim me Procedurën Standarde të Operimit - Standardet e Kontrollimit Kufitar, në drejtim të ofrimit të një shërbimi efikas të kontrollit.

3.4.11. Fushë e inspektimit ka qenë edhe verifikimi i funksionimit të Sistemit të Menaxhimit Kufitar (SMK) në pikat e kalimit kufitar, duke përfshirë integrimin e funksionimit të tij në mbajtjen dhe shkëmbimin e informatave siç parashihet me PSO-në në fuqi. Nga informatat e siguruar nga drejtues të Departamentit për Kufi, SMK ka shtrirje të plotë në tërë kufijtë, është funksional dhe plotësisht biometrik. Në këtë sistem vendosen të gjitha informatat nga fusha e kontrollit kufitar. Informacionet sigurojnë së SMK është i ndërlidhur me sistemet tjera në kuadër të Policisë dhe MPB-së. Sipas raportimeve të drejtuesve, funksionimi i SMK-së është mjaft fleksibil, përmbanë të gjitha shënimet e nevojshme për kontrollin kufitar, si: shënimet për historikun e hyrje-daljeve për personat dhe automjetet, alertet, Stop-listat, njoftimet tjera me rëndësi, si dhe integrimin dhe funksionimin në mbajtjen dhe shkëmbimin e informatave. Shërbimet e SMK-së luajnë rol primar në menaxhimin dhe ushtrimin e kontrollit kufitar, prandaj Policia Kufitare inkurajohet që të vëjë në shfrytëzim kapacitetet e plota që siguron ky Sistem për qëllim të realizimit të objektivave të përcaktuara, kryerjes efektive të detyrave dhe ngritjes së vazhdueshme të performances.

3.4.12. Rregullat dhe procedurat e kapitullit III, pika 3 të Procedurës Standarde të Operimit-Sistemi për Menaxhim Kufitar rregullojnë procesin e rifreskimit të informatave në Stop Listë në kuadër të SMK-së, ku është paraparë aktivizimi dhe deaktivizimi i informatave në Stop Listë. Nga intervistat me drejtues të Departamentit për Kufi dhe kontrollet në terren nëpër kabina në kuadër të PKK-ve

është vërtetuar se Stop Lista është funksionale dhe në tërë SPK-të. Stop Lista është e inkorporuar në kuadër të SMK (BMS), në të cilën regjistrohen të gjitha rastet e personave në kërkim, kërkesat për realizim të urdhërave të Gjykatës dhe kundërvajtjet e shqiptuara në trafik, të cilat presin për ekzekutim. Funksionimi i Stop Listës në PKK luan rol të rëndësishëm në fushën e menaxhimit dhe ushtrimit të kontrollit kufitar, duke kontribuar në ngritjen e sigurisë dhe luftimin e krimit. Krahas përpjesësive të funksionimit të Stop Listës, mbetet problematike aktivizimi, si dhe deaktivizimi i informatave në të, ngase rifresikimi i informatave nuk mund të aplikohet me kohë sepse ka vonesa në pranimin e vendimeve të gjykatave lidhur me rastet e ngritura. Në mungesë komunikimi azhur dhe vonesës së pranimit të vendimeve gjyqësore, ndodhë që numër i madh i rasteve edhe përkundër kryerjes së obligimeve të qytetarëve, të mbesin aktiv në Stop Listë, duke iu shkaktuar atyre ndalesa të paarsyeshme pa fajin e tyre. Sistemi SMK është i lidhur online me SIPK dhe në momentin që regjistrohet apo hiqet një shënim nga SIPK, i njëjti jep alert apo hiqet nga Stop Lista. Në Vërmicë në bazë të Marrëveshjes Ndërshtetërore Kosovë-Shqipëri për kontrollin hyrje/hyrje, SMK ka ndërlidhje me sistemin TIMS të Policisë së Shqipërisë. Këto sisteme komunikojnë me njëra tjetrën dhe shkëmbejnë informacionet e duhura dhe të plota, duke mbuluar kontrollin kufitar në dalje.

Rekomandimi nr. 11

IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi që në bashkëpunim me Drejtorët Rajonal të Policisë Kufitare të ndërmarrin veprimet e nevojshme në eliminimin e vonesave të paarsyeshme për rifreskimin e të dhënave, gjegjësisht aktivizimin e deaktivizimin e informatave në Stop Listë konform Procedurës Standarde të Operimit - Sistemi i Menaxhimit Kufitar, në mënyrë që t'u mos u cenohen të drejtat e qytetarëve në lëvizjen e lirë të tyre.

3.4.13. Ruajtja e serverëve të të dhënave të SMK-së dhe mbajtja e evidencave mbi hyrje-daljet për personat që hyjnë në zonën ku ruhen serverët e SMK-së ka qenë fushë interesi për inspektorët. Sipas drejtuesve, SMK ka serverë në nivel qendror dhe lokal. Në të gjitha PKK-të e inspektuara të kategorisë A, serverët ruhen me siguri të lartë dhe qasja në dhomën e serverëve është e kufizuar. Qasja në ndonjë nga dhomat e serverëve lejohet vetëm për zyrtarët e autorizuar, brenda tyre ka monitorim me kamerë si dhe bëhet evidentimi për hyrje/dalje. Serverët grumbullojnë dhe mbajnë të gjitha të dhënat mbi kontrollin kufitar. IPK ka evidentuar mangësi në mosmbajtjen e evidencave të hyrje-daljes në dhomat e serverëve në Han të Elezit. Në Jarinjë serveri është i vendosur në një kabinë në pjesën e prapme të kontejnerëve ku nuk ka monitorim me kamerë. Këto dobësi mund të ndikojnë në ushtrimin e duhur të kontrollit dhe sigurinë e këtyre aseteve policore.

Rekomandimi nr. 12

IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi që në bashkëpunim me Drejtorët Rajonal të Policisë Kufitare të ndërmarrin veprimet e nevojshme që në Stacionin Policor Kufitar - Hani i Elezit të mbahet evidencë mbi hyrje-daljet në dhomat e serverëve dhe në Stacionin Policor Kufitar-Jarinjë të instalohet sistemi i monitorimit me kamera në dhomën e serverëve, të gjitha këto në drejtim të shtimit të masave të sigurisë në mbrojtjen e evidencave mbi qarkullimin e njerëzve dhe mallrave përmes këtyre pikë kalimeve kufitare.

3.4.14. Gjatë këtij inspektimi janë vlerësuar edhe masat e ndërmarra të ruajtjes dhe sigurisë së vulave, si dhe mbajtja e evidencave të pranimit-dorëzimit të tyre konform Procedurës Standarde të

Operimit - Mbajtja e evidencave në PKK¹⁸. Sipas drejtuesve, për ruajtjen, sigurinë e vulave dhe aplikimin e procedurave të evidentimit të pranim-dorëzimit të tyre, personeli në PKK ka dijeni për standardet dhe procedurat e përcaktuara. Nga vizitat dhe vrojtimet e realizuara në Merdare, Hani i Elezit, Dheu i Bardhë, Kullë, Vërmicë, Jarinje dhe Aeroport, shihet se ruajtja e vulave dhe aplikimi i mbajtjes së evidencave të pranim-dorëzimit në masë të madhe realizohet konform kriterëve apo standardeve. Të gjitha vulat që janë në përdorim të kontrollit kufitar nga SPK-të kanë numra unik dhe ruhen në sefe të mbyllura. Përdorimi i tyre bëhet vetëm nën mbikëqyrjen e mbikëqyrësve me pranim-dorëzim. Brenda këtij procesi të punës, IPK ka evidentuar një sërë lëshimesh të personelit në disa stacione, të cilat mund të cenojnë efektivitetin dhe sigurinë e këtyre vulave. Janë evidentuar raste në disa stacione, kur vulat ruhen nëpër kasaforta jo të tejdukshme dhe sirtarë të tavolinave. Janë identifikuar raste kur ato ruhen në kasafortë të metaltë, si kushte që nuk përkojnë me standarde të kërkuara. PSO përcakton që vulat duhen të ruhen në kasafortë të tejdukshme. Në të gjitha SPK-të nuk aplikohet praktika për standardin e autorizimit me shkrim nga komandantët për shefat e ndërrimit me rastin e fillimit të përdorimit të vulave. Është evidentuar rasti në SPK-Jarinje ku në formularin për pranim-dorëzim të vulave hyrëse-dalëse¹⁹ mungon nënshkrimi i zyrtarit policor për kohën e dorëzimit. Nga intervistat me komandantë dhe zyrtarë policor kuptohet shqetësimi se autorizimi me shkrim për fillim të përdorimit të vulave shkakton prolongim të punës administrative dhe humbje kohe. Nga ta konsiderohet e panevojshme të praktikohet çdo ditë kjo procedurë. IPK vlerëson një kërkesë të tillë si të arsyeshme dhe ka vend për përmirësim të PSO-së ngase edhe në inspektimet e kaluara është hasur e njëjta problematikë.

Rekomandimi nr. 13

IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonal të Policisë Kufitare që në bashkëpunim me komandantët e stacioneve të ndërmarrin masat e sigurisë për ruajtjen dhe përdorimin e vulave konform Procedurës Standarde të Operimit - Mbajtja e evidencave në pikat e kalimit kufitar, në mënyrë që vulat të mbrohen nga keqpërdorimet apo humbjet eventuale.

¹⁸ Policia Kufitare, PSO - Mbajtja e evidencave në PKK, DDK-05/001/2014, date 11.02.2014.

¹⁹ Formulari për pranim-dorëzim të vulave hyrëse/dalëse i datës 16 qershor 2019, ora 08:00.

4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 10.12.2019, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të Veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore (origjinal)	Plani i veprimit
1.	IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi dhe Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbeshtetëse që të angazhohen në ndërmarrjen e veprimeve për përmirësimin e infrastrukturës së komunikimit në drejtim të mbulimit të zonave të vdekura me rrjet komunikimi, si dhe në furnizimin e patrullave kufitare me pajisje të radio-komunikimit (radiolidhje).	-I-	Rekomandimi qëndron. Kërkesa për nevojë të një sistemi të radio-komunikimit të qëndrueshëm dhe të besueshëm për Policinë Kufitare do ri-përcjellët në DTIK.	Janar 2025
2.	IPK-ja u rekomandon drejtuesve të stacioneve dhe udhëheqësve të ndërrimeve që të ushtrojnë kontroll të shtuar në respektimin e procedurës dhe rregullave për pranim-dorëzimin e armëve të gjata, si dhe për mbajtjen e evidencave lidhur me procedurat e tilla, në drejtim të shtimit të masave të sigurisë për kontrollin e tyre.	-I-	Rekomandimi qëndron. Do iniciohen inspektime në fushën e respektimit të PSO-se për pranim-dorëzim të armëve të gjata dhe municionit.	Mars 2020
3.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi që në bashkëpunim me Udhëheqësin Divizionit për Kontrollë dhe Mbikëqyrje të Kufirit, të analizojë trendet e kontrolleve të vijes së dytë për t'u siguruar se shkalla aktuale e kontrolleve të tilla është e mjaftueshme, në drejtim të përmbushjes së misionit për të garantuar siguri të shtuar kufitare dhe për të parandaluar dhe luftuar krimin ndërkufitar.	-I-	Rekomandimi qëndron. Do analizohet situata dhe do merren veprimet në baze të rekomandimeve për ngritje në kuantitet dhe kualitet të kontrolleve të vijës së dytë.	Mars 2020
4.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi që të analizojë trendet aktuale të performancës policore në tre nivelet e bashkëpunimit (brenda autoritetit, me akterët e MIK-ut dhe në rrafshin ndërkombëtar), në drejtim të përmbushjes së objektivave strategjike që dalin nga Plani i Veprimit të Strategjisë	-I-	Rekomandimi qëndron. Në takimin e ardhshëm të Bordit të MIK, do ngritet kërkesa për fuqizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes agjensioneve të involvuara në MIK.	Dhjetor 2020

	<i>për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (me theks të veçantë të analizohen indikatorët mbi operacionet brenda autoritetit, me akterët e përfshirë në MIK dhe në rrafshin ndërkombëtar.</i>			
5.	<i>IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Sektorit të Hetimeve të Departamentit për Kufi që në të ardhmen të ushtrorë kontroll të shtuar mbi vartësit në mënyrë që dosjet hetimore të mirëmbahen dhe të jenë të plota me tërë dokumentacionin e nevojshëm ashtu siç parashihet me Procedurën Standarde të Operimit - Sektori i Hetimeve të Departamentit të Policisë Kufitare.</i>	-I-	<i>Rekomandimi qëndron. Do iniciohet inspektim i dosjeve te rasteve hetimore si ne nivel qendror ashtu ne nivel lokal lidhur me përputhshmërinë me PSO relevante.</i>	Mars 2020
6.	<i>IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj që të ushtrorë kontroll të shtuar mbi vartësit në respektimin e procedurave dhe rregullave për largimin (deportimin) e të huajve nga territori i vendit tonë dhe mirëmbajtjen e dosjeve siç parashihet me kriteret e vëna me Procedurat e Njësisë së Deportimeve.</i>	-I-	<i>Rekomandimi qëndron. Do iniciohet inspektim i dosjeve te rasteve te deportimit te te huajve lidhur me përputhshmërinë me PSO relevante</i>	Mars 2020
7.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi që në bashkëpunim me Drejtorin e Drejtorisë së Personelit të ndërmarrin veprimet konkrete drejt vendosjes dhe shpërndarjes së burimeve njerëzore në pajtim me strukturën e aprovuar, duke i kushtuar kujdesin e duhur shpërndarjes sasiore sipas numrit dhe gradave.</i>	-I-	<i>Rekomandimi qëndron. Ne bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit do angazhohemi ne shpërndarjen e personelit sipas strukturës organizative ne fuqi.</i>	Janar 2021
8.	<i>IPK-ja u rekomandon drejtuesve të Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare që në bashkëpunim me Divizionin e Trajnimeve të ndërmarrin veprimet e nevojshme për përfshirjen e zyrtarëve policor në trajnimin e riçertifikimit konform afateve të përcaktuara me Rregulloren për Personel e Administratë, në drejtim të ripërsëritjes dhe rifreskimit të njohurive dhe shkathtësive policore.</i>	-I-	<i>Rekomandimi qëndron. Ne bashkëpunim me Departamentin e Trajnimit, te gjithë zyrtaret policor do kompletojnë Ri-certifikimin mandator sipas afateve te caktuara.</i>	Janar 2021
9.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi dhe drejtuesve të drejtorive dhe stacioneve policore që në të ardhmen të ngrisin nivelin e kontrollit të kualitetit, duke praktikuar metodologjinë e inspektimit apo kontrollit në rajonet e tyre siç e përcakton Procedura Standarde e</i>	-I-	<i>Rekomandimi qëndron. Do përpilohen orare për inspektime te rregullta dhe te jashtëzakonshme si nga niveli qendror ashtu nga niveli lokal.</i>	Mars 2020

	<i>Operimit - Kontrolli i kualitetit, në mënyrë që kontrollet të jenë më cilësore dhe të prekin fushat e ndjeshme.</i>			
10.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi që në bashkëpunim me Drejtorin e Departamentit për Shërbime Mbështetëse të ndërmarrë veprimet e nevojshme për pajimin e Stacioneve Policore të Mbikëqyrjes së Kufirit me automjete dhe pajisje për patrullim kufitar në pajtim me Procedurën Standarde të Operimit - Standardet e Mbikëqyrjes së Kufirit, si dhe pajimin e Stacioneve Policore Kufitare me pajisje të nevojshme të kontrollit kufitar në pajtim me Procedurën Standarde të Operimit - Standardet e Kontrollimit Kufitar, në drejtim të ofrimit të një shërbimi efikas të kontrollit.</i>	-I-	<i>Rekomandimi qëndron. Ne bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse do iniciohen kërkesa për prokurimin e pajisjeve të nevojshme për patrullimin dhe mbikëqyrjen e vijës së gjelbër kufitare.</i>	Janar 2021
11.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi që në bashkëpunim me Drejtorët Rajonal të Policisë Kufitare të ndërmarrin veprimet e nevojshme në eliminimin e vonesave të paarsyeshme për rifreskimin e të dhënave, gjegjësisht aktivizimin e deaktivizimin e informatave në Stop Listë konform Procedurës Standarde të Operimit - Sistemi i Menaxhimit Kufitar, në mënyrë që t'u mos u cenohen të drejtat e qytetarëve në lëvizjen e lirë të tyre.</i>	-I-	<i>Rekomandimi qëndron. Ne takim me institucionet tjera bashkëpunuese do kërkohet që informatat kthyes të nevojshme për StopListe të dërgohen në afatet sa më të shkurtra kohor.</i>	Në vazhdimësi
12.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Kufi dhe Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që të angazhohen në ndërmarrjen e veprimeve për përmirësimin e infrastrukturës së komunikimit në drejtim të mbulimit të zonave të vdekura me rrjet komunikimi, si dhe në furnizimin e patrullave kufitare me pajisje të radio-komunikimit (radiolidhje).</i>	-I-	<i>Rekomandimi qëndron. Ne bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse do vlerësohet situatat dhe do merren masat e nevojshme lidhur me sigurinë e serverëve në PKK.</i>	Qershor 2020
13.	<i>IPK-ja u rekomandon drejtuesve të stacioneve dhe udhëheqësve të ndërrimeve që të ushtrojnë kontroll të shtuar në respektimin e procedurës dhe rregullave për pranim-dorëzimin e armëve të gjata, si dhe për mbajtjen e evidencave lidhur me procedurat e tilla, në drejtim të shtimit të masave të sigurisë mbi kontrollin e tyre.</i>	-I-	<i>Rekomandimi qëndron. Do rishikohet PSO-ja në fuqi dhe situata në terren dhe varësisht nga situata do merren masat drejtpërdrejtoresisht të sigurisë dhe përdorimit të vulave zyrtare në PKK.</i>	Janar 2021

Shtojca 1: Të dhëna mbi përmbushjen e rekomandimeve nga inspektimet e mëparshme				
Gjetjet nga inspektimi i mëparshëm (viti 2017)				
Inspektimi: Menaxhimi i ruajtjes dhe kontrollit të kufirit dhe migracionit, nr. 06/2017				
Nr.	Rekomandimi i dhënë	Komentet e strukturës policore (në origjinal)	Afatet për zbatim	Niveli i zbatimit
1.	<i>IPK-ja u rekomandon Departamentit të Kufirit që në bashkëpunim me Divizionin e Burimeve Njerëzore të bëjnë një analizë të nevojave për burimet njerëzore dhe të ndërmarrin hapa konkret drejt vendosjes së tyre varësisht nga numri dhe gradat, të përcaktuar me Listën e Autorizuar të Personelit.</i>	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm dhe do të zbatohet nga ana e Departamentit për Kufi në bashkëpunim me Departamentin për Burime Njerëzore. Vitin e kaluar është krijuar një grup punues në nivel të Policisë së Kosovës, ku edhe Departamenti për Kufi është i përfaqësuar në vlerësimin e nevojave për personel, në kuantitete dhe kualitete.</i>	<i>Gjatë vitit 2018</i>	<i>Vlerësimi nga IPK-ja: Përgjithësisht</i>
2.	<i>IPK-ja i rekomandon Departamenti të Kufirit që të analizojë gjendjen aktuale dhe të shqyrtojë fuqizimin e mekanizmit për lëvizjen e personelit, përfshirë edhe atë të graduar në kuadër të strukturës policore të kufirit, duke marrë parasysh faktorët ndikues, por gjithnjë duke vlerësuar se kjo mund t'i shërbejë shëndetit të organizatës dhe ngritjes së efikasitetit brenda shërbimit.</i>	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm dhe do të zbatohet nga ana e Departamentit për Kufi. Do të ketë vështitësi në zbatimin e këtij rekomandimi, për shkak të mungesës së kapaciteteve në realizimin në tërësi të këtij rekomandimi.</i>	<i>Viti 2020</i>	<i>Vlerësimi nga IPK-ja: Plotësisht</i>
3.	<i>IPK-ja i rekomandon Departamentit të Kufirit që në të ardhmen të ndërmarrë veprimet e nevojshme që konform Rregullores për Personel dhe Administratë, si dhe Procedurës Standarde të Operimit për rregullat dhe procedurat e trajnimeve dhe studimeve në Fakultetin e Sigurisë Publike, të përfshijë personelin policor në trajnimet e nevojshme, përfshirë ato të brendshme, trajnimet rricerfitikuese dhe trajnimet tjera të nevojshme për Policinë Kufitare.</i>	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm dhe do të realizohet nga Departamenti për Kufi në bashkëpunim me Departamentin për Burime Njerëzore, dhe Departamentin për Shërbime Mbështetëse.</i>	<i>Rekomandimi do të realizohet gjatë vitit 2019, për të gjitha trajnimet e brendshme dhe ricertifikuese, ndërsa për studime në Fakultetin e Sigurisë Publike, do të</i>	<i>Vlerësimi nga IPK-ja: Përgjithësisht</i>

			varet nga kapacitetet e Fakultetit, si dhe interesimi i shprehur brenda PK-së	
4.	IPK-ja i rekomandon Departamentit të Kufirit, që varësisht nga mundësitë buxhetore për avancimin e infrastrukturës teknike në fushën e menaxhimit të ruajtjes dhe kontrollit të kufirit, të pajisë të gjitha stacionet policore kufitare me pajisjet e nevojshme të kontrollit kufitar, siç përcaktohet me PSO-në mbi Standardet e Kontrollit Kufitar.	Rekomandimi është i qëndrueshëm dhe do të realizohet nga Departamenti për Kufi, në bashkëpunim me Departamentin për Shërbime Mbështetëse, si dhe agjencitë e huaja, të cilat na mbështesin me pajisje. Është një proces në vazhdimësi i avancimit në pajisje dhe teknologji në kontrollin kufitar.	Gjatë vitit 2018 si dhe viteve në vazhdim.	Vlerësimi nga IPK-ja: Përgjithësisht
5.	IPK-ja i rekomandon Departamentit të Kufirit që të sanojë problemet teknike që krijojnë pengesa në kryerjen e kontrolleve dhe regjistrimeve të nevojshme në Sistemin e Menaxhimit Kufitar (SMK) dhe po ashtu të ndërmarrë hapat e nevojshëm në bashkëpunim me DTIK-un dhe njësitë tjera policore në përditësimin e informatave në Stop-Listë në kuadër të SMK-së.	Rekomandimi është i qëndrueshëm dhe do të realizohet nga Departamenti për Kufi në bashkëpunim edhe me agjencitë tjera (DTIK, Gjyqësorin, Prokurorinë, etj)	Ky rekomandim do të realizohet gjatë vitit 2018, në vazhdimësi edhe gjatë viteve në vijim, pasi që do të varet edhe nga veprimi i agjencive tjera, me kërkesën e të cilave, personat janë vendosur në Stop-Listë.	Vlerësimi nga IPK-ja: Përgjithësisht
6.	IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorit të Departamentit të Kufirit, që të ndërmarrin veprimet e nevojshme në sanimin e gjendjes së rëndë me automjete, në mënyrë që të eliminohen situatat që mund të ndikojnë në rënien e efektivitetit dhe të performancës së njërive policore kufitare.	Rekomandimi është i qëndrueshëm. Departamenti për Kufi në vazhdimësi ka bërë vlerësimin e nevojave për automjete, tek Departamenti për Shërbime Mbështetëse, të cilat nuk kanë mundur të realizohen në vitet e mëparshme. Ky është një	Për realizimin e këtij rekomandimi do të jetë vështirë të përcaktojmë afate kohore.	Vlerësimi nga IPK-ja: Nuk është përmbushur

		<i>problem, i cili po e përcjell Departamentin në vazhdimësi, dhe po reflektohet në kontrollin kufitar si dhe sigurinë kufitare.</i>		
7.	<i>IPK-ja u rekomandon një sive hetimore që trajtojnë rastet e ngritura penale që të përkujdesen në evitimin e dobësive apo mangësive të evidentuara gjatë inspektimit lidhur me shenjat e gishtërinjëve dhe raportet njoftuese për Prokurorin e Shtetit, konform Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, kurse drejtuesve të një sive hetimore, kujdes të shtuar gjatë mbikëqyrjes së trajtimit të rasteve.</i>	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm. Departamenti për Kufi do ta realizojë këtë rekomandim.</i>	Shtator 2018	Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Pjesërisht</i>
8.	<i>IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Departamentit për Kufi që të kujdeset në përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe të sigurisë në objektet policore ku zhvillojnë aktivitetet DRPK-të, SPK-të dhe SPMK-të, duke shtuar përpjekjet për një punë cilësore dhe efektive të personelit në raport me standardet e kërkuara.</i>	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm. Departamenti për Kufi në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse do të punojë në përmirësimin e infrastrukturës, me të cilën do të ngritet edhe kualiteti i sigurisë në objektet policore kufitare.</i>	Viti 2020	Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Përgjithësisht</i>